



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË
GJUHA SHQIPE DHE MATEMATIKA**



@matura-shqiptare

Për të gjithë nxënësit dhe mësuesit
e Gjuhës Shqipe dhe Matematikës

Mars 2020

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

GJUHA SHQIPE DHE MATEMATIKA

Për të gjithë nxënësit dhe mësuesit
e Gjuhës Shqipe dhe Matematikës



@matura.shteterore

© QSHA 2020

Mars 2020

Qendra e Shërbimeve Arsimore u krijua për të ndikuar në procesin e të nxënit në shkollë përmes vlerësimit. Me qëllim që ta përmbushë këtë mision të saj, ajo është përpjekur maksimalisht të sigurojë se të gjitha vlerësimet që ajo ndërmerr, të jenë të drejta, etike dhe në përputhje me standardet teknike.

Ne jemi të ndërgjegjshëm mbi shkallën në të cilën vlerësimi ndikon në modelet dhe përmbajtjen e të nxënit në klasë. E gjithë puna jonë, në koherencë me kurrikulën, thekson rëndësinë e përputhjes mes qëllimeve, pedagogjisë, materialeve të të nxënit dhe vlerësimit.

Ky material është hartuar të kontribuojë në këtë proces koherence.



@matura.shitetoro

Qendra e Shërbimeve Arsimore ofron një metodë drejt një cilësie më të lartë, drejt një lidhjeje më të mirë midis të nxënit dhe vlerësimit, duke nxitur përmirësimin e procesit të të nxënit në klasë.

Si ta lexojmë këtë material

Për ta bërë sa më të lehtë përdorimin e këtij materiali, përmbajtjen e tij e kemi ndarë në seksione.

Seksioni 1 përmban testet e përdorura në PKAB, lënda e gjuhës shqipe, bashkë me një informacion mbi përmbajtjen e testit, kompetencat që vlerëson, nivelet e vështirësisë së testit, llojet e pyetjeve etj.

Seksioni 2 përmban testet e përdorura në PKAB, lënda e matematikës, bashkë me një informacion mbi përmbajtjen e testit, kompetencat që vlerëson, nivelet e vështirësisë së testit, llojet e pyetjeve etj.

Seksioni 3 përmban skemat e vlerësimit për testet e përdorura në PKAB, lënda e gjuhës shqipe dhe matematikës.



@matura.shitetere

Pasqyra e lëndës

1. SEKSIONI 1

Testimi dhe modele testesh në Gjuhë Shqipe9

2. SEKSIONI 2

Testimi dhe modele testesh në Matematikë96

3. SEKSIONI 3

Skema të vlerësimit të testeve të Gjuhës Shqipe dhe të Matematikës.....127



@maturashiteteror

HYRJE

Matja e arritjeve të nxënësve në përfundim të një niveli arsimor, shërben jo vetëm për të pasqyruar funksionimin e sistemit arsimor në kontekstin e politikave arsimore aktuale, por edhe për të ndërtuar politika të reja arsimore. Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos kur kjo lidhet me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës.

Nxënësit, mësuesit, drejtuesit e shkollave, politikëbërësit, prindërit dhe publiku i gjerë kanë nevojë që të kenë informacionin e duhur lidhur me arritjet dhe progresin e sistemit arsimor dhe sa mirë ky sistem i përgatit nxënësit për t'u përballur me jetën. Rezultatet e provimeve të kombëtare të arsimit bazë, si një vlerësim i jashtëm i standardizuar, japin të dhënat e nevojshme për të monitoruar sistemin arsimor dhe nivelin e arritjeve të nxënësve.

Ky material përmban testet e provimeve kombëtare të arsimit bazë, për gjuhën shqipe dhe matematikën, të shoqëruara bashkë me skemat e vlerësimit.

Ky material u shërben mësuesve, specialistëve të arsimit, nxënësve dhe të gjithë të interesuarve në funksion të përmirësimit në arritjen e standardeve të mësimdhënies dhe të të nxënësve në shkollë.

Çfarë është Provimi Kombëtar i Arsimit Bazë

PKAB është një provim kombëtar që zhvillohet në përfundim të arsimit 9-vjeçar të detyruar dhe shërben për të certifikuar nxënësit që përfundojnë këtë cikël arsimimi.

Ky provim mat njohuritë dhe kompetencat e tyre në tri fusha:

- Gjuhë shqipe
- Gjuhë e huaj
- Matematikë

Ky provim synon gjithashtu dhënien e informacionit për prindërit, mësuesit, si dhe të gjitha institucionet e arsimit në vend në lidhje me arritjet e nxënësve në kompetenca të caktuara të secilës fushë.

Cili është qëllimi i këtij publikimi?

Përmes këtij publikimi, ku përmbledhen disa teste të Gjuhës shqipe të përdorura në vite në Provimin Kombëtar të Arsimit Bazë, synojmë t'u japim nxënësve, prindërve, mësuesve dhe të interesuarve të tjerë një mundësi që të familjarizohen me përmbajtjen e testit dhe llojet e pyetjeve që përdoren në të. Kur nxënësit e dinë se çfarë duhet të bëjnë në një test të Gjuhës shqipe, ata përgatiten edhe më mirë në një situatë më praktike, ku përfshihen të gjitha hapat që ka një test i tillë i standardizuar.

PËR NXËNËSIT

Nxënësit mund t'i përdorin këto modele:

- për t'u familjarizuar me llojet e pyetjeve;
- për të mësuar se si t'i japin përgjigjet e tyre.

Duke parë këto modele disa kohë përpara testimit, nxënësit do të kuptojnë se çfarë do t'u kërkohet të bëjnë. Si rezultat, ata do të jenë në gjendje të fokusohen në demonstrimin e aftësive të tyre në Gjuhën shqipe në ditën e testimit.

PËR PRINDËRIT

Prindërit mund t'i përdorin këto modele:

- për të kuptuar kompetencat që nxënësit duhet të demonstrojnë në testin e Gjuhës shqipe;
- për të kuptuar llojin e pyetjeve për të cilat fëmijët e tyre do të përgjigjen në test për të demonstruar se i zotërojnë këto kompetenca.

PËR MËSUESIT

Mësuesit mund t'i përdorin këto modele:

- për të kuptuar llojin e pyetjeve që përdoren në testin kombëtar të Gjuhës shqipe;
- për të kuptuar se si lidhen pyetjet me kompetecat që nxënësit duhet të zotërojnë në përfundim të arsimit të detyruar 9-vjeçar dhe që janë përshkruar në dokumentin zyrtar të kurrikulës së Gjuhës shqipe.
- për t'i ndihmuar nxënësit të familjarizohen me kërkesat e testit;
- për të krijuar modele të ngjashme në klasë në ndihmë të nxënësve.



@matura.shteterore

SEKSIONI 1



@maturashitetore

TESTIMI DHE MODELE TESTESH NË GJUHË SHQIPE

Hartimi i testit të Gjuhës shqipe bazohet në një metodologji të mirëpërcaktuar. Natyrisht një test i tillë nuk mund të vlerësojë të gjitha njohuritë dhe kompetencat që nxënësi ka përfutur gjatë të gjitha viteve të shkollimit. Specialistët që hartojnë testin, kanë për detyrë të fokusohen në një përmbajtje të caktuar të lëndës, e cila specifikohet përmes programit orientues të Maturës, të hartuar nga ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar).

Në mënyrë të përmbledhur çdo test i Maturës Shtetërore ka disa specifikime, ku bëjnë pjesë:

- përmbajtja: njohuri, shprehi, kompetenca,
- formati i testit (llojet e pyetjeve),
- totali i pyetjeve në test,
- totali i pikëve në test,
- nivelet e vështirësisë së testit dhe pyetjet për secilin nivel,
- koha (e testit dhe për secilën pyetje),
- pikëzimi i pyetjeve.

Kompetencat në Gjuhën shqipe

Të gjitha kompetencat lëndore, mbi të cilat bazohet përmbajtja e testit, hartohen nga ASCAP. Bazuar në këto kompetenca, QSHA përgatit **objektivat e vlerësimit** (të specifikuar më poshtë), të cilat lidhen me rezultatet e arritjeve të të nxënësve. Duke qenë se provimi i Arsimit Bazë zhvillohet me shkrim, kompetencat *gjuhësore* që do të vlerësohen janë:

- **Të lexuarit e teksteve të ndryshme në mënyrë aktive dhe kritike**, që nënkupton atë që nxënësi jo vetëm t'i kuptojë, por edhe t'i vlerësojë njohuritë që komunikohen në tekst. Ai veçon ide kryesore në tekst, nxjerr përfundime nga informacioni i tekstit, bën përgjithësime në nivel kritik, analizon elementë të stilit. Së fundi, ai përcakton funksionet, llojin, qëllimet, teknikat dhe karakteristikat gjuhësore të teksteve joletrare.
- **Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**, që lidhet me sigurinë dhe aftësinë që fiton nxënësi në të shkruar, përmes formave dhe stileve të ndryshme të të shkruarit. Në këtë rast nxënësi planifikon shkrimin në përputhje me qëllimin, lexuesin dhe kontekstin, përdor strategji të ndryshme të shkrimit, duke organizuar fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin, mbështet mesazhin

kryesor të një teksti me detaje, fakte e shembuj të përshtatshëm, i përmbahet temës së esesë në një punë me shkrim.

- **Përvetësimi i rregullave të drejtshkrimit dhe pikësimit**, që pasqyrohet në saktësinë në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes, në njohjen e regjistrave të gjuhës dhe zbatimin e rregullave të drejtshkrimit. Nxënësi dëshmon aftësi të fituara gjuhësore të morfologjisë, fjalëformimit, sintaksës, leksikologjisë, drejtshkrimit, në përdorimin saktë të fjalëve, në shkrimin dhe përdorimin saktë të shenjave të pikësimit, në kalimet nga ligjërata e drejtë në të zhdrejtë, në fjalitë e ndërmjetme a të ndërkallura.



@matura.shteterore

Përshkrim i përgjithshëm i testit të Gjuhës shqipe

Testi i Gjuhës shqipe për klasën IX të Arsimit Bazë mbështetet në standardet e kurrikulës së këtij arsimit.

Ai përbëhet nga tri pjesë dhe mat progresin e nxënësve kundrejt kompetencave në Gjuhën shqipe.

Përmbajtja e testit

Testi i Gjuhës shqipe mat dy kompetenca kryesore të nxënësit:

të lexuarit dhe të shkruarit.

Ai përbëhet nga tri pjesë dhe ka një total prej 50 pikësh.

Pjesa I- tekst joletrar

Pjesa II- tekst letrar

Të dy pjesët matin kompetencën e të lexuarit.

Pjesa III: përfshin njohuritë gramatikore dhe rubrikën të shkruajmë.

Kohëzgjatja e testit është 2 orë e 30 minuta.

Objektivat e vlerësimit në testin e Gjuhës Shqipe

Të lexuarit

Niveli I

Nxënësi:

1. identifikon ngjarjet kryesore në një histori, shkaqet e tyre dhe ndikimin që ato kanë në zhvillimet e mëvonshme;
2. dallon personazhet- karaktere;
3. dallon figurat letrare, si: personifikimi, epiteti, apostrofi, paralelizmi figurativ, metafora me qëllim që të përcaktojë funksionin e tyre;
4. dallon dhe interpreton fjalët me kuptime të ndryshme;
5. identifikon argumentet e duhura në lidhje me një çështje të caktuar.

Niveli II

Nxënësi:

1. zbulon karakteret e personazheve, duke provuar të bëjë edhe analiza të “botës” psikologjike të tyre;
2. përcakton shkaqet e veprimeve të një personazhi;
3. zbërthen figurat letrare duke treguar funksionin shprehës të tyre;
4. përmbledh idetë dhe mban qëndrim kritik ndaj tyre;
5. analizon fragmente të ndryshme për të përcaktuar rolin e personazheve në konflikt.

Niveli III

Nxënësi:

1. vlerëson gjuhën e një teksti.
2. interpreton qëllimet e autorit dhe përdorime të caktuara në vepër;
3. krahason pjesë të ndryshme brenda fragmentit;
4. komunikon një përgjigje personale të ndjeshme dhe të arsyeshme në lidhje me veprën e lexuar.

Të shkruarit

Niveli I

Nxënësi:

1. shkruan rreth një teme të caktuar: një ngjarje, një përshkrim, një mbyllje pjese etj;
2. lidh idetë brenda fjalive dhe midis paragrafëve.

Niveli II

Nxënësi:

1. përzgjedh një mënyrë organizimi të përgjigjes në lidhje me temën e dhënë;
2. identifikon detajet mbështetëse në lidhje me temën që po trajton apo përfundimin;
3. realizon lidhjet brenda fjalive dhe paragrafëve.

Niveli III

Nxënësi:

1. sintetizon informacionin në lidhje me një temë të caktuar;
2. analizon detajet mbështetëse dhe t'i vendosë ato në funksion të temës ose përfundimit të përgjigjes;
3. krijon lidhje midis fjalive dhe paragrafëve.

Njohuri rreth gjuhës

Niveli I

Nxënësi:

1. dallon fjalët e përbëra;
2. dallon frazeologjinë nga fjalët e urta dhe fjalia e thjeshtë;

3. përcakton klasën e fjalëve: lidhëzat, parafjalët;
4. dallon mënyrën dhe kohën e foljes;
5. identifikon përemrin vetor, pronor, të pacaktuar etj;
6. identifikon kryefjalën dhe me se është shprehur ajo;
7. identifikon llojin e kundrinorit dhe me se është shprehur ai;
8. identifikon llojin e fjalive sipas kumtimit;
9. identifikon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra.
10. shkruan saktë fjalët.

Niveli II

Nxënësi:

1. analizon fjalën sipas përbërësve të saj;
2. analizon emrin në kategoritë e tij gramatikore;
3. analizon veçoritë gramatikore të përemrit vetor;
4. identifikon llojet e fjalive të përbëra me bashkërenditje;
5. dallon funksionet e fjalëve në një fjali.

Niveli III

Nxënësi:

1. identifikon dhe vendos si duhet shenjat e pikësimit në fjalitë komplekse.
2. zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Blu printi i testit - (tabela e specifikimeve)

Nr	Fusha	Përqindja	Pikët	Niveli I	Niveli II	Niveli III
1	Të lexuarit	50%	25	10	10	5
2	Të shkruarit	13%	6	2	2	2
3	Njohuri gjuhësore	37%	19	8	8	3
	Totali	100%	50	20	20	10

Pjesët e leximit

Në testin e Gjuhës shqipe nxënësve iu jepen dy pjesë për të lexuar. Pjesa joletrare mund të jetë informuese, shpjeguese, argumentuese, përshkruese ese etj. Pjesa letrare mund të jetë prozë, poezi ose dramë.

Pasi lexojnë pjesët, nxënësit i përgjigjen një grupi pyetjesh, të gjitha të lidhura me tekstet e dhëna në test.

Tekstet (letrare dhe joletrare), të përdorura në testin e Gjuhës shqipe, janë të përshtatshme për nxënësit e kësaj moshe. Në përzgjedhjen e tyre nga hartuesit e testit është marrë parasysh aspekti cilësor dhe sasior, i cili është në përputhje me kërkesën e pyetjeve që kërkohen të zgjidhen nga ana e nxënësve. Gjatë hartimit të testit, gjykimi profesional, përvoja, si dhe të dhënat cilësore dhe sasimore janë përdorur për të vendosur nëse niveli i çdo teksti të përzgjedhur është në përshatje me nivelin shkollor të nxënësve.

Nëse teksti i përzgjedhur është informues/shpjegues, ai duhet të përmbajë një temë të qartë dhe t'u adresohet koncepteve dhe ideve të ndryshme. Nëse teksti është

argumentues, ai duhet të përmbajë këndvështrime të kundërta. Çdo pikëpamje duhet paraqitur qartësisht, kështu që çdo nxënës mund të pozicionohet në atë anë që dëshëron.

Tekstet duhet të jenë interesante, të konceptuara në mënyrën e duhur, të reflektojnë çështje dhe tema të jetës së përditshme dhe të mos kufizohen në situata që lidhen vetëm me shkollën apo mjedisin e klasës. Në tekste nuk duhen përfshirë pjesë me përmbajtje të diskutueshme nga ana etike, morale apo me elemente fyese. Gjithashtu, duhen shmangur tema që shkaktojnë ndjesi konfuze apo ngarkesa të tepërta emocionale.

Zakonisht, në testin e Gjuhës shqipe, secili tekst ka një numër fjalësh që varion nga 500-600.

Tekstet vlerësohen edhe nga pikëpamja cilësore, domethënë nga niveli i të kuptuarit brenda tekstit, kompleksiteti i strukturës së përgjithshme të tij, lloji i gjuhës së përdorur etj.

Lloji i pyetjeve në test

Në testin e Gjuhës Shqipe për Provimin e Arsimit Bazë përdoren pyetje të tipeve të ndryshme: me alternativa, me përgjigje të shkurtër, me përgjigje të hapur dhe ese.

Pyetjet me alternativa

Pyetjet me alternativa kërkojnë nga nxënësi të qarkojë alternativën e saktë midis një grupi të pasaktash ose hutuesesh. Vështirësia e këtyre pyetjeve varet nga mënyra se si i ndërtojmë alternativat. Sa më i ngushtë të jetë dallimi midis alternativës së saktë dhe të pasaktave (hutueseve), aq më e vështirë është pyetja.

Pyetjet me alternativa janë hartuar për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në Gjuhë shqipe. Këto pyetje i kërkojnë nxënësit të analizojë aspekte të ndryshme të teksteve të dhëna në test, të tilla si: ideja qendrore, qëllimi i trajtimit të një teme a çështjeje të caktuar në tekst, faktet dhe opinionet, shkaqet dhe pasojat, elemente të stilit, zhvillimi i personazheve dhe përmbajtjes, si dhe fjalori.

Nxënësi mund t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve me saktësi, nëse kupton shumë mirë dhe di si ta përdorë përmbajtjen e të gjithë tekstit.

Pyetjet me përgjigje të shkurtër

Si pyetjet me alternativa, ashtu edhe pyetjet me përgjigje të shkurtër janë hartuar për të vlerësuar standardet e arritjeve në lëndën e Gjuhës shqipe. Këto janë pyetje ku nxënësi duhet të përdorë shembuj nga teksti për të mbështetur përgjigjen e tij ose të arrijë në një përfundim (një pohim, një pozicionim apo konkluzion), bazuar në analizën që i bën pjesës.

Qëllimi i këtyre pyetjeve është të vlerësojnë aftësitë e nxënësit për zbulimin, përzgjedhjen dhe grumbullimin e informacionit, për të kuptuar dhe analizuar tekstin.

Për të dhënë një përgjigje, nxënësit duhet të shkruajnë fjali të plota. Zakonisht, përgjigjet nuk kërkojnë më shumë se tri fjali të tilla.

Pyetjet me përgjigje të hapur dhe ese

Këto pyetje janë hartuar për të matur aftësitë e nxënësve për të shkruar, bazuar në tekst ose në një kërkesë të caktuar (pyetjet ese). Këto janë pyetje që vlerësojnë nivele të larta të arritjeve të nxënësve (aftësitë interpretuese, argumentuese, krahasuese etj).

Ato kërkojnë që nxënësi të komunikojë një përgjigje të qartë dhe koherente, bazuar ose jo në tekstet e dhëna.



MODELI I
@matemashitetore

PJESA I

Ja si u bëra tregimtar

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Unë jam nga jugu, ndaj që në fëmijëri e ndieja se do të bëhesha tregimtar. Që herën e parë, kur dëgjova një histori, madje shumë kohë para se të mësoja të lexoja, e dija se do të dëshiroja të rrëfeja edhe vetë. Unë vij nga një familje ku televizori shuhet kur dikush është duke rrëfyer diçka në verandë. Historitë ishin ndodhi që ma tërhiqnin gjithnjë kureshtjen. Familja jonë përbëhej nga pesë fëmijë, mamaja dhe babai, madje dhe gjyshja, e cila jetoi me ne për pak kohë. Ndaj në kohën e drekës, ju e imagjinoni, që të gjithë kërkonin sa më shumë vëmendje. Unë e dija se, nëse do të mund të rrëfeja diçka interesante, mund të isha në qendër të grupit. Historitë ishin diçka shumë e rëndësishme për familjen time, sepse dijet çmoheshin shumë. Jo thjesht libra me informacion, edhe pse familja ime ishte familje lexuesish, por pikërisht njohja e dukurive. Leximi respektohej shumë në shtëpi. Mamanë time do ta gjeje gjithmonë duke lexuar një libër me kapak kartoni në karrigen e saj të madhe me ngjyrë të kuqe dhe nga ne kërkohej që në atë moment të mos e shqetësonim për asnjë arsye. Nuk po flas këtu për revista, oh jo, por për libra me *kapakë kartoni*. Dhe unë isha i vogli i familjes, ai që vraponte tërë kohës rreth e qark duke bërtitur: “Kush më do, kush më do mua!”, ndërsa mendoja: “Ç’është ajo gjë kaq e rëndësishme për mamanë, saqë e mban atë larg meje?”. Kur ajo ngrihej, duke e lënë librin mbi karrige, unë e merrja dhe e shikoja me kureshtje. Por nuk pashë kurrë ndonjë ilustrim, por vetëm fjalë. Dhe mendoja: “Oh zot, duhet të ketë diçka magjike këtu”.

Nuk mbaj mend të kem pyetur ndokënd në lidhje me ndonjë përvojë të tillë, të përafërt. Mendoj se, ndoshta, të shkruarit u kthye në diçka shumë të rëndësishme për brezin tim, sepse prindërit tanë ishin shumë të lidhur me arsimin dhe sigurisht që ai ishte baza mbi të cilin ngriheshin jetët tona.

Ndaj interesimi im për të shkruar ndoshta u shfaq që në shtëpi, me historitë e shkurtra dhe më pas, në mënyrë të natyrshme kaloi te librat. Tashmë historitë vijnë te unë në të gjitha mënyrat e mundshme. Romani im i parë “*Fëmija i familjes*” erdhi te unë pjesë - pjesë. Ai filloi si një histori e shkurtër, për një vajzë të vogël, që jetonte në një qytet provincial, në jug të vendit, e cila shkonte, përmes një rruge tërë pluhur, në një sallon bukurie, pasi i pëlqente shumë të rregullonte flokët. Vajza shkonte

shpesh atje, sepse ishte shumë e kujdesshme për pamjen e saj dhe gjyshja me mamanë, meqenëse nuk duronin dot ta shikonin duke qarë, e lejonin të shkonte sa herë të donte.

Njëherë ajo takon atje një grua shumë të bukur, me një lëkurë të zeshkët, të cilën nuk e kishte parë kurrë më parë. Kur gruaja filloi të fliste, vajza kuptoi nga dialekti i saj se ajo nuk ishte nga ai vend, por nga një ishull në det. Më vonë, gruaja e mbështolli vajzën me krahët e saj dhe i mësoi shumë gjëra: si të bëhej një zonjushë e vërtetë, të bënte pyetje, të njihje botën.

Kur e dërgova këtë histori për botim, ma refuzuan disa herë, prandaj u trishtova shumë. Punova sërish me të dhe e ridërgova, por prapë ma refuzuan. Më në fund e kuptova se nuk kisha më një histori të shkurtër. Kisha nevojë të mësoja se kush ishte në të vërtetë vajza e vogël, ku jetonte, çfarë ndodhi kur u kthye në shtëpi, si ishin prindërit e saj, kur shkonte në shkollë. Sapo i mësova këto gjëra rreth saj, historia filloi të bëhej gjithnjë e më e gjerë. E dija se vajza e vogël ishte e veçantë dhe në atë moment e kuptova se duhej të shkruaja një roman.

1. Bazuar në **paragrafin e parë**, çfarë beson autori në lidhje me librat me *kapakë kartoni*? **1 pikë**
 - A) Ato ishin një privilegj që u takonte vetëm të rriturve.
 - B) Ato ishin të mërzitshme sepse nuk kishin ilustrime.
 - C) Ato meritonin më tepër respekt se çdo gjë tjetër e shkruar.
 - D) Ato siguronin një burim të mirë frymëzimi për historitë e familjes.
2. Çfarë mësoi autori nga refuzimet që i bënë historisë së shkurtër që dërgoi për botim? **1 pikë**
 - A) Historia kishte një subjekt të vështirë për t'u trajtuar.
 - B) Historitë me vajza të vogla nuk i tërheqin shumë të rriturit.
 - C) Historia nuk ishte e plotë kur e shkroi fillimisht.
 - D) Historitë e shkurtra janë më të vështira për t'u shkruar se sa romanet.
3. Çfarë bëri autori për ta kthyer historinë e shkurtër në roman? **1 pikë**
 - A) Ndryshoi mjedisin.
 - B) Zhvilloi personazhet.
 - C) E bëri gjuhën më përshkruese.
 - D) Krijoi një përmbajtje më të fokusuar.


PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

4. Duke parë interesin që familja e tij kishte për librin, autori mësoi të vlerësonte: **1 pikë**

- A) rëndësinë e rrëfimit bukur të historive.
- B) rëndësinë e të qenit më i vogli në familje.
- C) studimin e autorëve të ndryshëm.
- D) historitë që rrëfente gjyshja e tij.

5. Në ç'mënyrë fëmijëria e autorit ndikoi në vendimin e tij për t'u bërë shkrimtar?

Përdorni ilustrime nga pjesa për të mbështetur mendimin tuaj. **4 pikë**



@matura.shteterore

PJESA II

Leximi i përbashkët

[Gjatë pushimeve, Marseli takohet me Izabelën, moshataren e vet. Një ditë vajza iu lut djalit të dëgjonte "historinë më të bukur në botë" atë të "Shitëses së vogël të shkrepëseve", që ajo do ta lexonte enkas për të. Marseli fillon të dëgjojë Izabelën.]

Që në rreshtin e parë të tregimit, bënte ftohtë, ishte errësirë, binte borë. Këto kushte të këqija atmosferike nuk kishin të bënin aspak me mua, që, përkundrazi, po kolovitesha nën hijen e vakët të një akacieje, buzë bokërimës plot diell.

Në rreshtin e pestë, e gjora fëmijë, që ishte me kokë të zbuluar, humbi shapkat nga hutimi dhe tashmë i duhej të "ecte mbi dëborë, me këmbët e zbatshura që i ishin skuqur e mavijosur nga të ftohtët."

Fillimisht mendova se ishte e pazonja të çalltiste për vete, se prindërit e saj qenë kriminelë që e linin të dilte vetëm përjashta, mes borës dhe se ai që e tregonte këtë histori, përpiquej si e si të më bënte të ndieja keqardhje; nuk pranoja, pra, të ndieja dhe unë të ftohtë nga këmbët së bashku me të; mirëpo Izabela e kishte marrë me mjaft seriozitet dhe lexonte me këmbëngulje, si të kishte përpara një gazetë. Të bëhej sikur ajo kishte shumë zëra. Herë zë të ftohtë e monoton, si bora që binte, herë zë lakmuës e të ngrohtë tek thoshte: "Tërë rruga ishte mbushur me erën e mishrave që piqeshin" dhe herë zë therës nga zemërimi, kur djali i lig i vodhi shapkën e dytë të pafajshmes vajzë...

Fillimi që kur vogëlushja u përpoq të ngrohete "të shkretat duar të kallkanosura nga të ftohtët", duke ndezur "fijet e shkrepëses njëra pas tjetrës". Nuk kishe si të mos prekeshe nga kjo mënyrë krejt e kotë për t'u ngrohur dhe, tek e përfytyroja të zbehej e të mavijosej e tëra, u vura në merak të madh se si do t'i shkonte vallë filli heroinës sonë.

Magjia e shkaktuar nga flaka "magjepsëse" e atyre shkrepëseve (doemos suedeze) më ngushëlloi një çast, nxitur nga gëzimi i papritur i zërit të Izabelës, që i bënte një përshkrim të arrirë këtyre përfytyrimeve të mrekullueshme dhe shfaqja e gjyshe më dha një ndjenjë sigurie, megjithëse m'u duk diçka e pashpjegueshme. Më në fund, kur të dyja, gjyshe e mbesë, mbërritën tek i miri Zot, ç'kënaqësi për mua që ai ishte i pranishëm për t'u dhënë lumturinë që u takonte. Po historia nuk mori fund me kaq!

Rrëfenjësi mizor bënte një zbulim të tmerrshëm në rreshtat e fundit. Izabela u mëshoi me një ton të ngadaltë, me një dhembshuri që ia dridhte, ia mbyste zërin dhe, kur ajo tha: “vdekur, vdekur nga të ftohtët, natën e fundit të vitit”, nuk kishte si të vijonte më tej dhe lot të sumbullt i rrodhën përgjatë faqeve të zbehta.

Nuk arriti ta përmbante ngashërimin. Së fundi, mezi i doli zëri për të vijuar: “Dita e parë e vitit zbardhi mbi kufomën e vogël, nderur mbi tokë, mes shkrepëseve të saj të djegura!...”

Atëherë m’u bë sikur e vdekura e vogël ishte ajo vetë, Izabela. E pashë krejt të bardhë midis borës dhe u hodha nga hamaku* për t’i shkuar në ndihmë. Ajo më shmangu lehtë me dorë, duke më thënë me zë të mbytur:

- Prit!

Lexoi rreshtat e fundit: “Askush nuk i kishte njohur bukuritë që ajo kishte parë, as tërë ato vezullime mes të cilave ajo depërtoi tok me gjyshen e saj plakë atë natë të Vitit të Ri”.

Këto vezullime as që mund të më ngushëllonin. Ajo kishte vdekur nga të ftohtët dhe kjo që e tëra. Gjithçka tjetër ishte sa për sy e faqe dhe, tek e shihja Izabelën të çohet përpjetë në ajër, mbajtur për dore nga një plakë me flokë të bardhë, që ngrihej dhe ajo lart, lot të mëdhenj më rrokulliseshin faqeve dhe unë shtrëngoja fort gjoksin tim për ta mbajtur mbërthyer mbi tokë.

Mes lotëve, Izabela ia dha së qeshurës:

- Sa budalla që bëhesh! – foli ajo. - Përrallë është, asgjë e vërtetë. Si s’te vjen turp që qan kështu?

- Pse, ti s’po qan?

- Unë jam gocë. Pastaj, unë kam qejf të qaj edhe kur është për të qeshur. Kurse për një çun...

***hamak** – shtrat prej pëlhure, varur midis degëve të një peme.

6. Në fjalinë: “të shkretat duar të kallkanosura nga të ftohtët” fjala të **kallkanosura** ka kuptimin: **1 pikë**

- A) të çara;
- B) të lodhura;
- C) të ngrira;
- D) të zbardhura.

7. Cila nga fjalitë e mëposhtme përshkruan lidhjen midis asaj çka ndodh në tregim dhe mënyrës se si tregimtari e rrëfen tregimin? **1 pikë**

- A) Ai tregon ngjarje të dhimbshme në mënyrë humoristike.
- B) Ai tregon ngjarje të dhimbshme në mënyrë emocionuese.
- C) Ai tregon ngjarje të përditshme në mënyrë sensacionale.
- D) Ai tregon ngjarje të jashtëzakonshme me vërtetësi.

8. Çfarë mendon djali për përrallën që i tregon Izabela? **1 pikë**

- A) Është zhgënjyese dhe të mërzit.
- B) Është prekëse dhe intriguese.
- C) Është e ngarkuar me hollësi të tepërta.
- D) Është e përshtatshme për fëmijët e moshës së tij.

9. Në cilën prej fjalive të mëposhtme gjuha merr një ngarkesë të theksuar emocionale? **1 pikë**

- A) Këto vezullime as që mund të më ngushëllonin.
- B) Nuk kishe si të mos prekeshe nga kjo mënyrë krejt e kotë për t'u ngrohur.
- C) Izabela e kishte marrë me mjaft seriozitet dhe lexonte me këmbëngulje.
- D) ...dhe herë zë therës nga zemërimi, kur djali i lig i vodhi shapkën e dytë të pafajshmes vajzë...

10. Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon se kjo histori është shkruar në vetën e parë? **1 pikë**

- A) Që në rreshtin e parë të tregimit, bënte ftohtë, ishte errësirë, binte borë.
- B) Rrëfenjësi mizor bënte një zbulim të tmerrshëm në rreshtat e fundit.
- C) Ajo kishte vdekur nga të ftohtët dhe kjo qe e tëra.
- D) Atëherë m'u bë sikur e vdekura e vogël ishte ajo vetë, Izabela.

11. I gjithë **paragrafi i parë** i tregimit ngrihet mbi bazën e një kontrasti. Cili është ai? **1 pikë**

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

12.

a) Shpjegoni se çfarë natyre është djali. Ku duket kjo?


2 pikë

b) Djali dallohet për një imagjinatë të zhvilluar. Identifikoni **dy momentet** kur ajo shfaqet veçanërisht e tillë.

2 pikë

c) Si reagon Izabela kur shikon djalin që qan?

1 pikë



@matura.shteterore

13.

a) A mendoni se Izabela është një vajzë e ndjeshme apo një interpretuese shumë e talentuar?

Argumentoni mendimin tuaj edhe me ilustrime nga tregimi.

3 pikë

- b) Cili është mendimi juaj në lidhje me fjalët që vajza thotë në fund të këtij tregimi? Shpjegoni nëse jeni ose jo dakord me të. **2 pikë**

- c) Si mendoni, çfarë mund të ketë thënë djali për të mbrojtur veten e tij në mbyllje të tregimit? **1 pikë**

- d) Përgjatë tregimit hasim shpesh disa fjalë ose fjali, të cilat autori i ka futur midis thonjzave dhe që janë me shkronja të pjerrëta.

Për ç'qëllim ai e bën këtë?

1 pikë



@matematika_shteterore

PJESA III

14. Cila nga grupet e fjalëve është shprehje frazeologjike? **1 pikë**

- A) mendova se ishte e pazonja
- B) vdekur nga të ftohtët
- C) ishte sa për sy e faqe
- D) plakë me flokë të bardhë

15. Në fjalinë: *Ai përpiqej të më bënte të ndieja keqardhje* emri i nënvizuar është: **1 pikë**

- A) në kallëzore të pashquar
- B) në emërore të pashquar
- C) në kallëzore të shquar
- D) në dhanore të shquar

16. Në fjalinë: *E pashë krejt të bardhë midis borës dhe u hodha për të ndihmuar* vajzën e gjorë forma e pashtjelluar ka funksionin e: **1 pikë**

- A) rrethanorit të shkakut;
- B) rrethanorit të qëllimit;
- C) rrethanorit të mënyrës;
- D) përcaktorit.

17. Gjjeni mbiemrin në këtë fjali dhe tregoni shkallën e tij. **2 pikë**

Izabelën e pashë krejt të bardhë midis borës dhe u hodha për t'i shkuar në ndihmë.

Mbiemri: _____

Shkalla: _____

18. Në fjalinë e mëposhtme gjeni një fjalë të përngjitur dhe thoni se cilës klase fjalësh i përket: **2 pikë**

Mirëpo Izabela e kishte marrë me mjaft seriozitet dhe lexonte me këmbëngulje.

Fjala: _____

Klasa: _____

19. Ç'pjesë ligjërate janë fjalët e nënvizuara në fjalinë më poshtë? **2 pikë**

Atëherë m'u bë sikur këto kushte të këqija atmosferike nuk kishin të bënin me mua..

20. Tregoni llojin e përemrit të nënvizuar në fjalinë e dhënë. **1 pikë**

Ajo m'u duk diçka e pakuptueshme për mua. Lloji: _____

21. Gjeni kryefjalën në këtë fjali: **1 pikë**

Mua as që mund të më ngushëllonin këto vezullime.

Kryefjala: _____

22. Gjeni kallëzuesin e përbërë në fjalinë e dhënë: **1 pikë**

Ajo zuri të fliste ngadalë: "Tërë rruga ishte mbushur me erën e mishrave që po piqeshin".

Kallëzuesi: _____

23.

- a) Gjeni një rrethanor në këtë fjali dhe tregoni llojin e tij. **2 pikë**

E pashë krejt të bardhë midis borës dhe u hodha ta ndihmoja, por ajo më shmangu lehtë me dorë.

Rrethanori: _____ Lloji: _____

- b) Gjeni mënyrën dhe kohën e foljes së nënvizuar në fjalinë e mëposhtme: **2 pikë**

...vogëlushja u përpoq të ngrohte "të shkretat duar të kallkanosura nga të ftohtët"...

Mënyra : _____ Koha: _____

24. Qarkoni fjalinë e përbërë dhe tregoni llojin e saj. **2 pikë**

- A) Këto kushte të këqija atmosferike nuk kishin aspak lidhje me mua.
B) Izabela lexonte me këmbëngulje, sikur të kishte përpara një gazetë.
C) Magjia é shkaktuar nga flaka "magjepsëse" e atyre shkrepëseve më ngushëlloi një çast.
D) Unë u hodha me shpejtësi për t'i shkuar në ndihmë menjëherë.

25. *Të shkruajmë*

E gjithë jeta jonë ndikohet nga fuqia e fjalëve: gjëra që prindërit na kanë thënë, poezi apo këngë që kemi dëgjuar, rreshta nga një roman që kemi lexuar, thënie nga mësuesi apo shoku.

Shkruani një ese ku të **përshkruani** ndikimin që disa fjalë mund të kenë pasur te ju.

Shtjellimi i idesë (25a)	Struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (25d)	Totali
2	1	1	2	6 pikë

MODELI II

@matura.shteterore



PJESA I

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Letra¹

Kur ka qenë hera e fundit që keni shkruar një letër? Ka shumë mundësi që të përgjigjeni: “Oh, ka shumë kohë.” Ndoshta nuk keni postuar kurrë një letër. Statistikat e shërbimit postar tregojnë se numri i letrave të dërguara me postë ka rënë në mënyrë dramatike që nga viti 2002. Pavarësisht se numri i popullsisë është rritur ndjeshëm, njerëzit sot dërgojnë më pak letra krahasuar me dhjetëra vite më parë. Kjo prirje ka shumë gjasa që të vazhdojë.

Ndoshta ka shumë arsye, por unë besoj se kjo ndodh për shkak të përdorimit të imeilit dhe të celularit. Çdo ditë e më shumë rritet numri i njerëzve që pëlqejnë më tepër të komunikojnë pandërprerë, se sa të bëjnë gjithë ato gjëra të domosdoshme për të postuar një letër, si: ta shkruajnë me dorë, ta fusin në zarf, t'i ngjisin zarfit një pullë poste dhe në fund ta hedhin letrën në kutinë postare. Sigurisht, përdorimi i teknologjive të reja e lehtëson më shumë komunikimin sesa ta bësh këtë përmes të shkruarit dhe postimit të një letre. Megjithatë, unë mendoj se përdorimi gjithnjë i imeilit apo i celularit në vend të një letre të shkruar me dorë, është një zgjedhje e varfër.

Le të shikojmë me kujdes se si i përdorim format e reja të komunikimit. Si celulari, edhe imeili na ndihmojnë që të jemi gjithnjë në kontakt me miqtë dhe familjet tona. Telefonat celularë janë një mënyrë shumë e mirë për të dëgjuar menjëherë zërin e një personi dhe për të pasur një komunikim të vazhdueshëm. Por e vërteta në lidhje me telefonat celularë është se shumica e bisedave janë të shkurtra dhe asgjë nuk na mbetet më pas në mendje. Gjithashtu, një nga pengesat më të rëndësishme në lidhje me to është se bisedat nuk mund t'i ruajmë apo t'i hedhim në letër. Herë pas here, kur lexojmë letrat, i ndiejmë më pranë njerëzit që ua kemi dërguar.

Ashtu si telefonat celularë, edhe imeilet na krijojnë mundësi që të komunikojmë më shpejt me familjen dhe miqtë tanë. Është shumë e lehtë të shkruash një njoftim në kompjuter. Nga ana tjetër, personi që merr njoftimin, mund të bëjë disa komente në të. I tërë ky shkëmbim mendimesh nuk ju merr më shumë

¹ Ky është një fjalim i mbajtur para një grupi mësuesish dhe nxënësish.

se disa minuta. Pavarësisht se dërgimi dhe marrja e imeileve janë mjete shumë të shpejta për të komunikuar, përsëri ato mbeten mënyra të varfra për të zëvendësuar bashkëbisedimet shprehëse.

Edhe pse letrat kërkojnë kohë për t'u shkruar dhe dërguar, ato janë forma më e paharrueshme e komunikimit. Kur shkruajmë një letër, përfshijmë shumë mendime të rëndësishme në të. Sapo organizojmë idetë, kemi nevojë për fjalët që t'i hedhim në letër. Përpjekja për të hedhur ide në letër e thellon mendimin tonë. Shkrimi i një letre është një lloj bashkëbisedimi me veten; në momentin që shprehim mendimet tona, ne mësojmë më shumë për to. Personi që e merr letrën, depërton në besimet tona, gjë të cilën ai nuk e ndien kur merr një përgjigje të shkurtër me imeil. Shpesh, njerëzit i ruajnë për shumë vite letrat e shkruara me dorë. Jetëgjatësia e një letre zgjat më tepër se ajo e një imeili.

Është fakt i mirënjohur se disa letra të shkruara nga njerëz të mëdhenj ruhen me shumë kujdes. Janë këto letra që na japin shumë informacione dhe detaje shtesë në lidhje me ngjarje të famshme historike. Letrat e shkruara nga Mark Tuein, Napoleoni dhe e shumë të tjerëve janë bërë publike. Në disa raste, ato na krijojnë mundësinë t'i hedhim një sy të shpejtë jetës së zakonshme të këtyre njerëzve të mëdhenj. Veç kësaj, ato na lejojnë të kuptojmë më mirë karakterin dhe mendimet e atyre që i kanë shkruar.

Ne mund të mendojmë se, meqenëse nuk jemi të famshëm, të tjerët nuk ka pse të jenë të interesuar për letrat tona. Unë nuk jam dakord me këtë! Kohët e fundit, gjyshja më tregoi disa letra që stërgjyshi im, pra i ati, i dërgonte familjes kur ishte në Luftën e Dytë Botërore. Ishte magjepsëse t'i lexoje ato! Gjyshja dhe xhaxhai më kishin treguar shumë histori për babanë e tyre dhe unë e di se ai kishte qenë një njeri që tregonte ndodhi të bukura gazmore. Por, sapo lexova letrat e tij, fillova të kuptoja se ai kishte qenë, gjithashtu, një njeri shumë mendimtar që i mungonte familja kur luftonte diku larg. Stërgjyshi im nuk ishte i famshëm, por ne mësuam kaq shumë për të, vetëm përmes letrave të tij që familja i kishte ruajtur me aq kujdes. Letrat janë një thesar i çmuar, përmes të cilave ai që i lexon, e vlerëson më shumë atë që i ka shkruar.

Megjithëse imeilet dhe celularët janë mjete komunikimi shumë të rëndësishme, besoj se të gjithë ne duhet t'i lëmë vetes më shumë kohë për t'u aftësuar që të shkruajmë letra të mira. Prandaj duhet të mësohemi të shkruajmë letra, herë pas here. Është e vërtetë se kjo do të na marrë më shumë kohë, por ka një përfitim. Duke shpenzuar më shumë kohë për të formuluar mendimet tona, ne bëhemi më të matur, mendojmë më shumë. Në këtë mënyrë, bëjmë diçka më

shumë se sa thjesht lëmë një shënim. Kështu, ne krijojmë kujtime të rëndësishme, të cilave mund t'u kthehemi herë pas here. Letrat zgjasin përgjithnjë!

1. Qëllimi kryesor i kësaj pjese është: **1 pikë**

- A) të krahasojë format e ndryshme të komunikimit.
- B) t'i bindë dëgjuesit që t'u kushtojnë kohë letrave të shkruara me dorë.
- C) t'u shpjegojë dëgjuesve pse imeilet janë një formë e përhapur e komunikimit.
- D) t'i informojë dëgjuesit në lidhje me pakësimin e numrit të letrave të shkruara gjatë kohëve të fundit.

2. Cila nga fjalitë e mëposhtme është edhe **tema** e kësaj pjese? **1 pikë**

- A) Ndoshta ka shumë arsye, por unë besoj se kjo ndodh për shkak të përdorimit të imeilit dhe të celularit.
- B) Megjithatë, unë mendoj se përdorimi gjithnjë i imeilit apo i celularit në vend të një letre të shkruar me dorë, është një zgjedhje e varfër.
- C) Ne mund të mendojmë se, meqenëse nuk jemi të famshëm, të tjerët nuk ka pse të jenë të interesuar për letrat tona.
- D) Megjithëse imeilet dhe celularët janë mjete komunikimi shumë të rëndësishme, besoj se të gjithë ne duhet t'i lëmë vetes më shumë kohë për t'u aftësuar që të shkruajmë letra të mira.

3. Cila nga fjalitë e mëposhtme është fakt? **1 pikë**

- A) Ishte magjepsëse t'i lexoje ato!
- B) Është shumë e lehtë të shkruash një njoftim të shpejtë në kompjuter.
- C) Është e vërtetë se kjo do të na marrë më shumë kohë, por ka një përfitim.
- D) Kohët e fundit, gjyshja më tregoi disa letra që stërgjyshi im, pra i ati, i dërgonte familjes kur ishte në Luftën e Dytë Botërore.

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

4. Për të shkruar këtë fjalim, autori punoi me një grup nxënësish, të cilët ndihmojnë njëri-tjetrin për të shprehur dhe prezantuar idetë e tyre. Për të realizuar këtë duhet që nxënësit: **1 pikë**

- A) të kërkojnë konsensus për idetë e përdorura në fjalimet e tyre.
- B) të bashkëbisedojnë për të shkëmbyer ide në një mënyrë të organizuar.
- C) të kërkojnë ide për fjalimet e anëtarëve të tjerë të grupit.
- D) të caktojnë një anëtar grupi për të regjistruar idetë e secilit.

5. Cila nga fjalitë e mëposhtme shpreh një mendim kritik/sugjerim për këtë pjesë? **1 pikë**

- A) Letrat e shkruara na tregojnë më shumë për karakterin e atij që i ka shkruar se sa imeilet.
- B) Një nga të mirat e letrave të shkruara është se ato zgjasin për një kohë të gjatë, nëse ruhen si duhet.
- C) Folësi duhet të na kishte paraqitur më shumë fakte në lidhje me format moderne të komunikimit.
- D) Për uljen e numrit të letrave të shkruara duhet fajësuar përdorimi i formave më të reja të komunikimit.

6. Cilat janë dy nga arsyet, që sipas autorit, kanë sjellë uljen e numrit të letrave të shkruara? **2 pikë**

a) _____ b) _____

7. Bazuar në informacionin e marrë nga kjo pjesë, zbërtheni nëntekstin që mbart fjalë e fundit: **2 pikë**

Letrat zgjasin përgjithnjë!

PJESA II

Lexoni historinë e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Udhëtim në mbretërinë e pemëve

Na ishte një herë një djalë i vogël që mërziqej. Ai kishte shumë dëshirë të udhëtonte, të nisej drejt detit apo edhe tutje horizontit. Po ja që pa mjete nuk mund të udhëtonte. Vogëlushi s'kishte as anije, as makinë, as tren, as edhe gjë prej gjëje. Atëherë detyrohej të ngulej në një vend, andaj edhe i hipte mërzia. Mirëpo, një ditë tha me vete: "Pse u dashka doemos të kesh krahë zogu apo fletë peshku për të udhëtuar"? E atëherë i lindi mendimi ta mbante vrapin drejt mbretërisë së pemëve. Në të vërtetë, ky mendim nuk i erdhi papritur. Kishte kohë që shkonte dhe endej pyllit, ku ndiente tërë ato gjëra të çuditshme; i dukej sikur pemët i kërkonin t'i flisnin, sikur pemët lëviznin; e shihje vogëlushin një ditë në një vend, një ditë në tjetrin dhe përherë i bëhej sikur pemët lëviznin. Doemos, kur vështron pemët, ato duket sikur kanë pamje të palëvizshme. Qëndrojnë pingul mbi tokë, me degët e tyre të hapura dhe me mijëra gjethe që dridhen e përdridhen.

E gjithë kjo është një mashtrim që bëjnë pemët për t'u dukur sikur qëndrojnë ngaherë në të njëjtin vend, për vite të tëra. Ato kanë pamje të qetë e të butë, të mbërthyer fort pas tokës së zezë nëpërmjet rrënjësh të fuqishme. T'i shohësh pa iu kushtuar vëmendje, mund të pandehësh se ato s'kërkojnë gjë, s'kanë gjëkafshë për të thënë. Mirëpo, vogëlushi e dinte se nuk ishte e vërtetë. Pemët nuk janë të palëvizshme. Ato duken sikur flenë, sikur bien në gjumë të thellë që zgjat me shekuj. Po vetë vogëlushi e dinte fare mirë se pemët s'flenë. Vetëm se janë disi të egra e të ndrojtura dhe, kur shohin dikë që iu avitet, shtrëngojnë darën e rrënjëve të tyre dhe bëjnë sikur kanë fjetur.

Kur ndodhesh në mbretërinë e pemëve dhe tregohesh i sjellshëm me to, është mirë të dish që pemët edhe mund t'ju shohin. Ka njerëz që thonë se pemët janë të verbra, të shurdhra e memece. Nuk është e vërtetë. Më fjalëshumë se një pemë nuk ka, sidomos kur i ke marrë me të mirë. Gjithashtu, ato kanë sy kudo, mbi secilën gjethe. Mirëpo këtë kurrkush s'e di. Duke qenë disi të ndrojtura, pemët zakonisht i mbajnë sytë mbyllur, kur përreth tyre sorollatet dikush. Djali i vogël, ai që kishte dëshirë të madhe të endej lart e poshtë mbretërisë së pemëve, kishte mësuar pak nga pak si t'i bënte pemët të hapnin syçkat. Fishkëllente me ëmbëlsinë më të madhe, jo ndonjë melodi, po ashtu si pemët, një a dy nota, fishkëllente ëmbël,

sa më ëmbël. Atëherë, mbi të gjitha gjethëzat e ngacmuara, djali vinte re tek hapeshin një nga një e lehtë-lehtë syçkat, ato syçka si të kërmijve. Dhe ka sy të të gjitha ngjyrave: të zinj, të verdhë, të trëndafilte, të kaltër, të çelët apo mavi. Çdo sy vështron vogëlushin e ulur mes çeltnës me një ndjesi vërtetë të çuditshme, sepse vështrimet i kanë shumë të ëmbla.

Vogëlushit ia ka ënda të kuvendojë me lisin e moçëm. I flet duke i fishkëllyer.

- Ti je mbreti i pyllit? – e pyet vogëlushi.
- Jo. Mbreti i pyllit banon shumë larg që këtej, në faqen tjetër të malit. Po lis, si unë është edhe ai.
- Duhet të jetë shumë i shkuar nga mosha, – i thotë vogëlushi.
- I shkuar thua! Ai ishte shumë i moçëm kur unë linda, këtu e tre mijë vjet më parë.

Vogëlushi ka një respekt të veçantë për lisin e moçëm.

- Sa mirë duhet të jetë të jetosh aq gjatë!
- Posi jo, mëson tërë ato gjëra, – ia kthen lisi.
- Një ditë, edhe ti ke për t'u bërë mbret i pyllit, – i thotë djali.
Lisi i moçëm krekoset pak nga lëvdata.
- Mbase. Në i shpëtofsha goditjes së rrufesë, edhe mundet...
- Po plepat, nuk bëhen dot mbretër?
Lisi i moçëm zgërdheshet duke fërshëllyer:
- Ç'i zë në gojë ata! Ata e kanë mendjen si e si të llototisin, si zogjtë. Të tërë në kuti shkrepësesh kanë për të përfunduar.

Vogëlushi trishtohet disi, sepse i do plepat. I kërkon leje për t'u larguar lisi të moçëm dhe vijon të shëtisë në pyll.

8. Kjo pjesë është marrë nga:

1 pikë

- A) një libër me tregime për fëmijë.
- B) një roman aventurash për fëmijë.
- C) një libër me përjetime personale.
- D) një artikull që trajton pse qytetet duhet të kenë më shumë hapësira të gjelbra.

9. Përshkrimi që autori i bën pyllit, të krijon idenë e një vendi: **1 pikë**

- A) të rrezikshëm, ku fëmijët mund të humbasin.
- B) joreal, që ekziston vetëm në imagjinatë.
- C) të zakonshëm, ku asgjë nuk ndodh.
- D) të populluar me kafshë dhe bimë të rralla.

10. Në cilën prej fjalive të mëposhtme është përdorur gjuha e figurshme? **1 pikë**

- A) Po ja që pa mjete nuk mund të udhëtonte.
- B) Kishte kohë që shkonte dhe endej pyllit.
- C) Më fjalëshumë se një pemë nuk ka, sidomos kur i ke marrë me të mirë.
- D) Ai kishte shumë dëshirë të udhëtonte, të nisej drejt detit apo edhe tutje horizontit.

11. Në fjalinë: *Ata e kanë mendjen si e si të llototisin, si zogjtë*, me fjalën *llototisin* djali nënkupton: **1 pikë**

- A) të flasin shumë.
- B) të grinden me njëri-tjetrin.
- C) të përqeshin njëri-tjetrin.
- D) të enden lart e poshtë.

12. Nisur nga biseda e djalit me lisin, çfarë veçorish duhet të ketë një lis për t'u bërë mbret i pyllit? **2 pikë**

a. _____ b. _____

13.

a) Çfarë kanë të veçantë prapashtesat e fjalëve: *syçkat, gjethëzat* (paragrafi III)? Cili është funksioni i këtij përdorimi? **2 pikë**

E veçanta: _____

Funksioni: _____

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

- b) Cili është roli i përsëritjes së lidhëzës as në fjalinë e dhënë më poshtë?

1 pikë

Vogëlushi s'kishte as anije, as makinë, as tren, as edhe gjë prej gjëje.

14.

- a) A mendoni se djali është thjesht një vizitor në pyll? Argumentoni mendimin tuaj.

2 pikë

- b) Djali ka një imagjinatë të zhvilluar. Identifikoni dy momente në fragment ku ajo shfaqet si e tillë.

2 pikë

- c) Autori e ka titulluar pjesën "Udhëtim në mbretërinë e pemëve". Çfarë do të ndryshonte nëse ai do ta kishte emërtuar "Udhëtim në pyllin me pemë"? Shpjegoni mendimin tuaj duke e ilustruar edhe me pjesë nga teksti.

3 pikë

PJESA III

15. Qarkoni fjalën e përngjitur. **1 pikë**

- A) përherë
- B) ulur
- C) të fuqishme
- D) fjalëshumë

16.

a) Emërtoni morfemat trajtëformuese te fjala *shkofsha*. **2 pikë**

b) Gjeni një çift antonimik në paragrafin e dytë të pjesës. **1 pikë**

c) Cilës klasë i përkasin fjalët e mëposhtme? **1 pikë**

apo, andaj, se, mirëpo _____

17. Qarkoni fjalinë ku është përdorur trajta e shkurtër. **1 pikë**

- A) E gjithë kjo është një mashtrim që bëjnë pemët për t'u dukur sikur qëndrojnë ngaherë në të njëjtin vend për vite të tëra.
- B) Një ditë, edhe ti ke për t'u bërë mbret i pyllit.
- C) Kur ndodhesh në mbretërinë e pemëve, dhe tregohesh i sjellshëm me to, është mirë të dish që pemët edhe mund t'ju shohin.
- D) Ato kanë pamje të qetë e të butë, të mbërthyer fort pas tokës së zezë nëpërmjet rrënjësh të fuqishme.

18. Përcaktoni shkallën e mbiemrit. **1 pikë**

Fishkëllente me ëmbëlsinë më të madhe, jo ndonjë melodi, po ashtu si pemët, një a dy nota, fishkëllente ëmbël, sa më ëmbël.

Shkalla: _____

19.

- a) Grupin emëror ato gjëra vendoseni në numrin njëjës, rasa dhanore. **1 pikë**

- b) Tregoni mënyrën dhe kohën e foljes së nënvizuar. **2 pikë**

Në i shpëtofsa goditjes së rrufesë, edhe mundet...

Mënyra: _____

Koha: _____

20. Gjeni kryefjalën në fjalinë e mëposhtme. Tregoni me se shprehet. **2 pikë**
Mirëpo këtë kurrkush s'e di.

Kryefjala: _____ Shprehur me: _____

21.

- a) Përcaktoni llojin kallëzuesit. Tregoni me se shprehet. **2 pikë**

Pemët nuk janë të palëvizshme.

Lloji: _____

Shprehur me: _____

- b) Përcaktoni llojin e rrethanorit të nënvizuar. Tregoni me se shprehet. **2 pikë**

Ato duket sikur flenë, sikur bien në gjumë të thellë që zgjat me shekuj.

Lloji: _____

Shprehur me: _____

22. Zgjeroheni fjalinë e dhënë me një pjesë të nënrenditur rrjedhimore. **1 pikë**

Të tërë në kuti shkrepësesh kanë për të përfunduar.

23. Qarkoni fjalinë me pjesë të nënrenditur përcaktore. **1 pikë**

- A) Sa mirë duhet të jetë të jetosh aq gjatë!
- B) Atëherë detyrohej të ngulej në një vend.
- C) E atëherë i lindi mendimi ta mbante vrapin drejt mbretërisë së pemëve.
- D) Atëherë, mbi të gjitha gjethëzat e ngacmuara, djali vinte re tek hapeshin një nga një e lehtë-lehtë syçkat, ato syçka si të kërmijve.

24. Qarkoni fjalinë e thjeshtë. **1 pikë**

- A) Kishte kohë që shkonte dhe endej pyllit.
- B) Na ishte një herë një djalë i vogël që mërzitej.
- C) Mirëpo, vogëlushi e dinte se nuk ishte e vërtetë.
- D) Çdo sy vështron vogëlushin e ulur mes çeltnës me një ndjesi vërtetë të çuditshme.



@matura.shtetere

MODELI III



@maturoshitetere

PJESA I

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Besimi

Në këtë pjesë autori përdor një shembull të thjeshtë për të arritur në një përgjithësim: të gjithë kemi një "kontratë" me njëri-tjetrin për të ndaluar kur semafori tregon dritën e kuqe, dhe i gjithë sistemi ynë i besimit varet nga ajo çfarë gjithkush bën.

Natën e kaluar po udhëtoja për në një qytet tjetër, një distancë prej 130 km. Ishte vonë dhe isha vonë. Nëse dikush do të më pyeste se sa shpejt po i jepja makinës, nuk do t'i përgjigjesha fare për këtë.

Në një moment u ndodha në një kryqëzim me semafor. Isha vetëm dhe, ndërsa po i afrohesha kryqëzimit, u ndez drita e kuqe e semaforit. Menjëherë frenova. Pashë majtas, djathtas dhe prapa. Asgjë.

Nuk kishte asnjë makinë dhe asnjë shenjë që të më tregonte se po afrohej një e tillë. Megjithatë, edhe pse isha e vetmja qenie njerëzore në një rreze prej disa kilometrash, qëndrova duke pritur që të ndryshonte drita e semaforit.

Fillova të pyesja veten se pse nuk vazhdova rrugën. Nuk i trembesha arrestimit, pasi ishte e qartë se nuk kishte asnjë polic aty pranë. Dhe, natyrisht, nuk kishte asnjë rrezik, nëse do të vazhdoja të ecja me makinë, edhe pse drita e semaforit ishte e kuqe.

Shumë më vonë, në mesnatë, pasi kisha takuar një grup miqsh dhe isha shtrirë në shtrat, fillova sërisht të pyesja veten se pse ndalova tek semafori. Mendoj se e bëra, ngaqë kjo është pjesë e një kontrate që kemi me njëri-tjetrin. Nuk është thjesht çështje ligji, por është një marrëveshje që kemi, dhe duhet t'i besojmë njëri-tjetrit për ta respektuar atë: të mos kalojmë kur drita e semaforit është e kuqe.

Ashtu si shumica, edhe unë, jam i prirur të mos e bëj diçka, dhe kjo jo për shkak se e kërkon ligji.

Është fantastike që ne kemi besim se tjetri do të bëjë gjënë e duhur apo jo? Besimi është prirja jonë. Ne duhet të marrim vendime të rëndësishme për të mos e besuar dikë apo kur ndihemi skeptik a dyshues.

E tërë struktura e shoqërisë sonë varet nga besimi reciprok dhe jo mosbesimi. Kjo gjë kaq e mirë do të shkatërrohej, nëse në shumicën e kohës nuk do t'i besonim njëri-tjetrit.

Ne bëjmë atë që themi se do të bëjmë. Ne vijmë atëherë, kur themi se do të vijmë.

Isha shumë krenar për veten, sepse ndalova kur duhej. Dhe, nëse dikush nuk do ta dijë ndonjëherë se sa njeri i mirë isha kur po udhëtoja me makinë nga një qytet në tjetrin, më duhet që t'ia tregoj vetë këtë.

1. Cila nga alternativat e mëposhtme përmbledh MË MIRË këtë pjesë? **1 pikë**

- A) Qeveria ka nevojë të forcojë ligjet. Nëse nuk ka ligje të forta, shoqëria mund të kalonte në kaos.
- B) Qëndrueshmëria e shoqërisë sonë bazohet tek besimi. Pa besim, kontrata që kemi me njëri-tjetrin do të shkatërrohej.
- C) Nëse nuk i besojmë njëri-tjetrit, njerëzit mund të revoltohen. Kontrata që kemi me njëri-tjetrin do të shkatërrohej.
- D) Duke i besuar njëri-tjetrit për t'iu bindur ligjit, ne ndërtojmë një qeveri të fortë. Ne duhet të kemi një polici të fortë, me qëllim që të sigurojmë qëndrueshmëri.

2. Cila është arsyeja më bindëse që jep autori, për të mos kaluar me dritë të kuqe? **1 pikë**

- A) Është kundër ligjit.
- B) Ne nuk kalojmë kur është drita e kuqe.
- C) Është pjesë e kontratës që kemi me njëri-tjetrin.
- D) Ne ndalojmë në një situatë të tillë, pasi kjo na bën krenarë.

3. Në një pjesë të shkrimit, autori kalon nga veta I njëjës në vetën I shumës. Pse e bën këtë? **1 pikë**

- A) T'i nxisë lexuesit t'u binden ligjeve të trafikut.
- B) T'i japë mundësi lexuesve të kuptojnë kontratën shoqërore.
- C) T'i nxisë lexuesit të identifikohen me pikëpamjen e autorit.
- D) T'i orientojë lexuesit që t'i konsiderojnë marrëveshjet më të rëndësishme se ligjet.

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

4. Në cilin moment autori filloi të ripyeste veten për arsyt e ndalimit kur pa dritën e kuqe të semaforit? **1 pikë**

- A) Pasi shkoi në shtrat.
- B) Ndërsa frenoi para semaforit.
- C) Ndërsa po priste që drita e semaforit të ndryshonte.
- D) Përpara se të arrinte në qytet.

5. Cila është ideja kryesore e kësaj pjese? **1 pikë**

- A) Ne duhet t'i respektojmë ligjet, edhe kur s'jemi dakord me to.
- B) Për të pasur një shoqëri të qëndrueshme, ne duhet t'i besojmë njëri-tjetrit.
- C) Ne ndalojmë kur semafori ka dritë të kuqe, sepse u bindemi marrëveshjeve shoqërore.
- D) Ne u tregojmë të tjerëve kur jemi të ndershëm, kështu ata nxiten të ndjekin rregullat.

6. Në çfarë përfundimi arrin lexuesi për autorin, pasi lexon këtë pjesë? **1 pikë**

- A) Ai beson se shumë njerëz janë mosbesues ndaj të tjerëve.
- B) Ai e konsideron veten një qytetar të bindur ndaj ligjit.
- C) Ai mendon se është një qytetar perfekt.
- D) Ai u beson ligjeve të shtetit.

7.

a) Pse autori ndihet krenar në fund? **1 pikë**

b) Pse ai kërkon që edhe të tjerë ta dinë se sa njeri i mirë është? **1 pikë**

PJESA II

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Largimi

Vogëlushi Paskal jeton i qetë së bashku me prindërit dhe hallë Martinën, diku, në një fermë fshati. Ai është porositur të mos largohet shumë nga shtëpia, sepse mund të kërcënohet nga rreziqe të ndryshme. Mirëpo, vogëlushi është i etur për të qenë i lirë. Një ditë të bukur gjen rastin kur nuk i ka prindërit në shtëpi dhe ia mbath. Pranë një lumi sheh një kasolle dhe pranë saj një barkë të vjetër.

Ajo qetësi, ajo heshtje e plotë më cytën në çast. Zbrita gjer te barka dhe pas një ngurrimi të vogël vura këmbën në buzë të saj; u anua nga pështa ime. Animi më hutoi disi. Po barka erdhi sërish në drejtpeshim. Zura vend me shumë kujdes në mes të saj, mbi ndenjësë, dhe nuk lëvizta më. Barka, uji dhe bregu më shfaqeshin si të ngrira dhe, megjithëse zemra më rrihte fort nga një ndjenjë frike e pakuptueshme, ndihesha po prapë i lumtur.

Me kurrizin kthyer nga bregu, tani nuk mund të shihja gjë tjetër para meje veç lumit. Ai rrëshqiste. Tutje, në rrjedhën e poshtme, ujdhesa¹ e përpirë nga rrezet e para të ditës, ishte duke dalë nga mjegullinat mëngjesore. Plepa, vidha e mëshhtëkna krijonin aty një tërësi të mpleksur. Përballë, një shkëmb i kaltëremë lartohej nga poshtë ujit, të cilin e çante egërsisht. Dhe uji buluronte tërë zemërim. Ndërsa bregu i ujdhesës mbetej gjithnjë i trëndafiltë. Përmes flladit që frynte, vinin prej andej kundërmime pemësh, bimësh e lulesh të egra, që ma mbanin gjoksin mbërthyer, krejt i mahnitur siç isha.

Barka rrinte si e ngrirë. As edhe një rrymë e dukshme nuk arrinte të prekte atë strehëz ku ndihesha i sigurt. Rrija e përhumbesha krejt duke soditur ujërat rrëshqitëse e të heshtura, lëvizja e të cilave më magjepste.

E humba krejt nocionin e kohës, vendit e të vetvetes, dhe nuk arrija më të kuptoja se cili lëvizte, barka apo lumi. Rrëshqiste lumi apo isha unë, që çuditërisht, pa lopata, e ngisja në të kundërt. Një zot e di si kisha arritur të shkëputesha nga bregu dhe tani rrija e vështroja si largoheshin katër shtyllat e kasolles... Ato po largoheshin... Vërtetë po largoheshin?...

Befas erdha në vete. Ku ndodhesha? Midis barkës dhe kasolles, litari kishte rënë. I përfshirë nga një rrymë e padukshme, po ikja kuturu. U përpoqa të kap kalimthi një degë; më shpëtoi nga duart. Pa një dridhje, në mënyrë të pandjeshme po shkëputesha nga bregu. Më hyri të ftohtit e frikës, nëpër trup më kaluan mornica. Sepse uji, fillimisht i qetë, rrëmbehej nga rryma sa më shumë që barka përparonte. Drejt meje shihja të vinte me shpejtësi shtresa tërësore e lumit.

Ajo ishte e gjitha në lëvizje. Masa e saj e thellë më tërhiqte drejt shkëmbit të ngritur thikë, ku dallgët thërrmoheshin duke gulfuar.

Egërsia e tyre po shtoej përherë e më shpejt dhe tërhiqnin pas vetes barkën e vjetër. Ajo kërciste. Uji brenda saj ngjitej nga të çarat. Mbylla sytë. Uji gjëmoi, pastaj barka, e kapur nga një vorbull, bëri një gjysmë kthese të ngathët. Një fërkim shkundi tërë trupin e saj. U ngul në shtratin prej zalli. Hapa sytë. Kisha shpëtuar. Barka dhe unë kishim përfunduar mbi një ranishte me pjerrësi të butë, në pjesën dalëse të ujdhesës

Shkëmbi, i shmangur, vazhdonte të shkumëzonte, po pak më tej.

Me një kërcim u hodha në tokë.

E atëherë, më shkuan lotët rrëke.

Qava e qava sa m'u ënjtën sytë. Kuptova se në ç'gjendje ndodhesha. Dyqind metra ujë i thellë më ndanin nga bregu im, nga bregu i banuar. Atje tymosnin vatrat e ngrohta familjare. Dy kilometra më tej, mes një buqete pishash e rrapesh, shtëpia ime, në atë kaltërsi agulllore, duhej të kishte nisur përpjetë fjollën e vet të tymit. Ishte ora nëntë. Tashmë, hallë Martina duhej të kishte nderur zjarrin bubulak me shkarpa. Dhe me siguri ishte vënë për të më kërkuar. Bëra një lëvizje të dëshpëruar. Si të dilja nga ujdhesa? Kë të thërrisja?

¹*Ujdhesë ~ ishull*

8. Në fjalinë: "Ajo qetësi, ajo heshtje e plotë më cytën në çast", fjala **cyt** ka kuptimin: **1 pikë**

- A) mpi,
- B) nxit,
- C) këput,
- D) frenoj.

9. Lexoni me kujdes paragrafin e dytë. Në ç'mënyrë autori e ndihmon lexuesin për të përjetuar të njëjtat emocione si djali kur shikon ujdhesën? **1 pikë**
- A) Duke theksuar nevojën e djalit për të qenë i vetëm në kërkimet e tij.
 - B) Duke theksuar dëshirën e djalit për të shkuar dhe për të parë nga afër ujdhesën.
 - C) Duke lënë të kuptohet se ujdhesa shumë shpejt do të mbulohet nga uji.
 - D) Dukë përdorur detaje emocionale për të përshkruar ujdhesën dhe ndikimin e saj tek djali.
10. Në cilën prej fjalive të mëposhtme është përdorur gjuha e figurshme? **1 pikë**
- A) Midis barkës dhe kasolles, litari kishte rënë.
 - B) U përpoqa të kap kalimthi një degë; më shpëtoi nga duart.
 - C) Tani rrija e vështroja si largoheshin katër shtyllat e kasolles...
 - D) Përballë, një shkëmb i kaltëremë lartohej nga poshtë ujit, të cilin e çante egërsisht.
11. Çfarë na tregon paragrafi i dytë në lidhje me natyrën e djalit? **1 pikë**
- A) Djali ka një shpirt të pasur dhe ndihet i lidhur me natyrën.
 - B) Djali ka një shpirt rebel dhe kërkon të pamundurën.
 - C) Djali është shumë kërkues dhe dëshiron ta sfidojë natyrën.
 - D) Djali është hezitues dhe i trembet së panjohurës.
12. Përshkrimi i ujdhesës që ndodhet në anën tjetër të bregut, krijon idenë: **1 pikë**
- A) e një vendi të rrezikshëm ku mund të humbasësh.
 - B) e një vendi jo real, por që ekziston vetëm në imagjinatë.
 - C) e një vendi të veçantë ku mund të ndodhin gjëra interesante.
 - D) e një vendi të populluar ku mezi orientohesh.



13.

- a) Cila është arsyeja që e shtyn djalin të hipë në varkë? **1 pikë**

- b) Kur varka fillon të lëvizë, djali ndodhet në rrezik. Identifikoni dy rreziqe që i kanosen atij. **2 pikë**

14. Pjesa në tërësi pasqyron ndjenja të ndryshme të djalit. Gjeni në paragrafin e parë një moment ku djali përjeton njëkohësisht dy ndjesi të kundërta. Shpjegoni arsyen e një përjetimi të tillë (kontradiktor). **2 pikë**

Momenti: _____

Shpjegimi: _____

15.

- a) Çfarë kupton djali, në lidhje me gjendjen e tij, kur ndodhet në ujdhesë? **1 pikë**

- b) Si do t'i interpretonit lotët në sytë e tij? Pse? **2 pikë**

GJUHA SHQIPE DHE MATEMATIKA

- c) Zbërtheni domethënien e paragrafit të fundit: ... *Atje tymosnin vatrat e ngrohta familjare...* deri te: *...kishte ndezur zjarrin bubulak me shkarpa...*, duke e ilustruar me detaje nga pjesa. **2 pikë**

- d) A mendoni se një fëmijë mund të largohet nga shtëpia pa lajmëruar familjarët? Po, jo?
Mendimin tuaj mbështeteni me dy argumente. **2 pikë**



@matura.shteterone

PJESA III

16.

- a) Shkruani kuptimin e fjalës kalimthi duke marrë parasysh përdorimin e prapashtesës th dhe kontekstin e përdorur. **1 pikë**

U përpoqa të kap kalimthi një degë; më shpëtoi nga duart.

- b) Cila është fusha leksikore e fjalëve: *plepa, vidha, mështekna*? **1 pikë**

- c) Shkruani temën fjalëformuese të fjalës drejtpeshim. **1 pikë**

- d) Cila fjalë është futur gabim sipas klasës ku bën pjesë? **1 pikë**

- A) i trëndafiltë,
B) të dëshpëruar,
C) të ftohtit,
D) i përfshirë.

17. Grupin emëror bregu im vendoseni në numrin shumës. **1 pikë**

18. Përcaktoni llojin e përemrit të nënvizuar dhe tregoni rasën e tij. **2 pikë**

As edhe një rrymë e dukshme nuk arrinte të prekte atë strehëz ku ndihesha i sigurt.

Lloji: _____ Rasa: _____

19. Rishkruani fjalinë duke vendosur mbiemrin në shkallën krahasore të sipërisë relative dhe duke i shtuar pjesën e dytë të krahasimit. **1 pikë**

Barka dhe unë kishim përfunduar mbi një ranishte me pjerrësi të butë.

20. Qarkoni fjalinë ku është përdorur trajta e shkurtër. **1 pikë**

- A) As edhe një rrymë e dukshme nuk arrinte të prekte atë strehëz ku ndihesha i sigurt.
B) Masa e saj e thellë më tërhiqte drejt shkëmbit të ngritur thikë, ku dallgët thërrmoheshin.
C) Sepse uji, fillimisht i qetë, rrëmbehej nga rryma sa më shumë që barka përparonte.
D) Egërsia e tyre po shtohej përherë e më shpejt dhe tërhiqnin pas vetes barkën e vjetër.

21.

- a) Vendoseni foljen në mënyrën habitore (pa ndryshuar kategoritë e tjera të saj). **1 pikë**

Barka rrinte si e ngrirë. _____

- b) Paskajoren e foljes *shih*te përdoreni në fjali një herë me funksion **qëllimor** dhe një herë si **përcaktor**. **2 pikë**

Funksion qëllimor: _____

Si përcaktor: _____

22.

- a) Gjени kryefjalën. Tregoni me se shprehet. **2 pikë**

Përballë, një shkëmb i kaltëremë lartohej nga poshtë ujit, të cilin e çante egërsisht.

Kryefjala: _____ Shprehur me: _____

- b) Gjени kallëzuesin. Përcaktoni llojin e tij. **2 pikë**

Shkëmbi, i shmangur, vazhdonte të shkumëzonte, po pak më tej.

Kallëzuesi: _____ Lloji: _____

23. Gjени rrethanorin e shkakut. **1 pikë**

Megjithëse zemra më rrihte fort nga një ndjenjë frike e pakuptueshme, ndihesha po prapë i lumtur.

Rrethanori i shkakut: _____

24.

- a) Rilexoni paragrafin e parë të historisë së dhënë më sipër. Duke u bazuar tek përmbajtja e tij, shkruani një fjali njëkryegjymtyrëshe foljore me vetë të përgjithësuar. **1 pikë**

- b) Fjalinë e dhënë zgjeroheni me pjesë të nënrenditur shkakore (PN1) dhe pjesë të nënrenditur filluese (PN2). **1 pikë**

Befas erdha në vete.

25. Të shkruajmë

6 pikë

Historia mbaron me fjalitë: “Bëra një lëvizje të dëshpëruar. Si të dilja nga ujdhesa? Kë të thërrisja?”

Bëni vazhdimin dhe mbylljen e ngjarjes në mënyrë të tillë që të jetë në të njëjtën linjë logjike me pjesën e shkruar.

Respektoni stilin dhe sintaksën e përdorur në tregim, me qëllim që krijimi të duket si një i tërë.



@matura.shteterore

Shtjellimi i idesë (25a)	Struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (25d)	Totali
2	1	1	2	6 pikë

MODELI IV



@matura.shitetereore

PJESA I

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Kur isha fëmijë, gjithnjë dëshiroja të largohesha nga shtëpia e të udhëtoja larg. Asokohe një imazh mbizotëronte në mendjen time: unë i vogël tek nxitoja i vetëm drejt së panjohurës. Doja të rizbuloja veten dhe pasione të reja. Ëndërroja e besoja për një vend tjetër ku mund të jetoja. E meqë isha tepër i vogël për t'u larguar, lexoja për këtë vend, fantazoja për lirinë time. Librat ishin rruga ime. Dhe më vonë, kur isha mjaft i rritur për të udhëtuar, rrugët nëpër të cilat kalova, u bënë pjesë e librave të mi. Me kalimin e kohës vura re se pjesa më e madhe e udhëtarëve të përkushtuar janë po ashtu, shkrimtarë dhe lexues pasionantë. Dhe kështu u krijua edhe ky libër.

Dëshira për të udhëtuar më duket një karakteristikë njerëzore: dëshirë për të lëvizur, për të shuar kuriozitetin, për të qetësuar frikërat, për të qenë i huaj, për të gjetur një mik, për të parë peizazhe ekzotike, për të rrezikuar brenda së panjohurës, për të qenë dëshmitar i pasojave të vendimeve që marrin njerëzit. Shpesh kam menduar se nëse i trembesh vetmisë, mos udhëto. Letërsia e udhëtimeve tregon ndikimin e vetmisë, ndonjëherë e trishtueshme, por edhe e vlefshme.

Për sa kohë kam udhëtuar, më kanë bërë të njëjtën pyetje: "Cili është libri yt i preferuar i udhëtimeve?" Si mund t'i përgjigjesh? Kam thujse pesëdhjetë vjet që udhëtoj dhe kam shkruar për udhëtimet e mia për gati dyzetë vjet. Një nga librat e parë, që im atë më lexonte përpara gjumit, ishte "I humbur në një mal". Libri fliste për historinë e një djali, të quajtur Doni, që mbijetoi tetë ditë në Malin Katahdin. Doni vuajti, por arriti të dilte nga pyjet. Libri më mësoi si të mbijetoja në një vend të egër, për shembull, gjithmonë duhet të kërkosh për burimin e një lumi a të një përroi.

Që atëherë kam lexuar shumë libra dhe kam udhëtuar në çdo kontinent, përveç Antarktidës, dhe për këtë kam shkruar tetë libra dhe qindra ese. Gjithmonë jam frymëzuar kur përfytyroja Donin e vogël që shpëtonte nga mali i lartë. Tregimet për udhëtimet janë më të vjetrat në botë, historira që udhëtari ua tregonte njerëzve të mbledhur rreth zjarrit pas kthimit të tij: lajme nga vende të largëta; tregime të çuditshme, të habitshme, të panjohura për kafshë a njerëz të tjerë. "Ata janë tamam si ne!" ose "Ata nuk na ngajnë aspak!" - thoshte më në fund ai.

Tregimi i ngjan një raporti e, megjithatë, ka edhe elemente fantastike, të cilat udhëtari ia shton nga përvoja e tij. Daniel Defoe u bazua në një ngjarje të vërtetë

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

kur shkroi "Robinson Kruzo", por i ekzagjeroi ndodhitë, duke e zgjatur historinë për 28 vjet e duke shtuar kanibalët e tropikun ekzotik.

Çdo tregimtar ka për qëllim ta mbërthejë lexuesin. Megjithatë, shumica e shkrimtarëve janë shakaxhinj, absurdë e mburravecë. Ndonjëherë historitë e tyre të tmerrojnë, të paralajmërojnë ose tingëllojnë tejet të njohura. Por, gjithmonë përpigjen të të tregojnë se si janë shumica e njerëzve kur udhëtojnë.

1. Cila është **tema** e kësaj pjese?

1 pikë

- A) Rëndësia e arsimit në jetë.
- B) Dëshira për të shkuar larg familjes.
- C) Qëllimet e ndryshme të dëshirave njerëzore.
- D) Udhëtimi si mënyrë e zbulimit të vetvetes.

2. Cila nga alternativat e mëposhtme mbështet përgjigjen e dhënë në pyetjen 1?

1 pikë

- A) Shpesh kam menduar se nëse i trembesh vetmisë, mos udhëto.
- B) Letërsia e udhëtimeve tregon ndikimin e vetmisë, ndonjëherë e trishtueshme, por edhe e vlefshme.
- C) Kam thujse pesëdhjetë vjet që udhëtoj dhe kam shkruar për udhëtimet e mia për gati dyzetë vjet.
- D) Tregimet për udhëtimet janë më të vjetrat në botë, historira që udhëtari ua tregonte njerëzve të mbledhur rreth zjarrit pas kthimit të tij.

3. Si e zhvillon autori idenë e tij se historitë e udhëtimeve janë të dobishme?

1 pikë

- A) Duke dhënë shembuj dhe tekste personale.
- B) Duke përshkruar një libër që ndikoi tek ai.
- C) Duke përshkruar shkrimtarët që admiron.
- D) Duke përcaktuar rolin e një tregimtari.

4. Cila nga alternativat e mëposhtme mbështet përgjigjen që keni dhënë në pyetjen 3? **1 pikë**

- A) Tregimet për udhëtimet janë më të vjetrat në botë.
- B) Çdo tregimtar ka për qëllim ta mbërthejë lexuesin.
- C) Tregimi i ngjan një raporti e, megjithatë, ka edhe elemente fantastike.
- D) Një nga librat e parë, që im atë më lexonte përpara gjumit, ishte "I humbur në një mal".

5. Cila nga fjalitë e mëposhtme është fakt? **1 pikë**

- A) Shpesh kam menduar se nëse i trembesh vetmisë, mos udhëto.
- B) Shumica e shkrimtarëve janë shakaxhinj, absurdë e mburravecë.
- C) Daniel Defoe u bazua në një ngjarje të vërtetë kur shkroi "Robinson Kruzo".
- D) Ndonjëherë historitë e tyre të tmerrojnë, të paralajmërojnë ose tingëllojnë tejet të njohura.

6.

a) Cila është një nga arsyet që autori e pëlqen shumë librin që i lexonte i ati në fëmijëri? **1 pikë**

b) Për të qenë një shkrimtar i mirë, duhet të kesh dy pasione shumë të mëdha. Zbulojini ato duke u bazuar tek përmbajtja e pjesës. **2 pikë**



@matura.shtetere

PJESA II

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Udhëtim në kohë

Është ditë vere. Shtëpia është plot me fëmijë; bën kohë e bukur, vapë dhe do të hamë drekë në oborr.

Po shkruaj duke shkuar nëpër mend tim atë, një ditë vere si kjo e sotmja, këtu e gjashtëmbëdhjetë vjet më parë. E shoh në këmbë për të fundit herë. Ndodhemi në shtëpinë e tij, bën kohë e bukur, si sot, dhe jemi duke ngrënë në kopsht. Në mendje kam veç tim atë, time bijë dhe vetveten.

E shoh të ulur, një dorë vënë mbi kofshë, tjetrën mbi tryezë. Pranë tij, një vogëlushe me sy të kafentë, të mëdhenj që vështron gjithçka. Ende nuk është dy vjeçe, pëlqen akulloren që ia japin në një tas qelqi, dhe me një ton tepër të sigurt për moshën që ka, thotë: "Sa e ftohtë!"

Atë ditë, im atë nuk e dinte që do të kisha edhe pesë fëmijë të tjerë pas saj, një varg të tërë me çuna, të cilët do të përjetësojnë jo vetëm gjenet, por edhe emrin e tij. Është shumë e rëndësishme të trashëgohet një emër: ai shqiptohet, shkruhet, përmendet, kujtohet, sjell kësaj jehonë e të qenurit të një njeriu. Kurse gjenet... Ajo çka lë pas dikush, para së gjithash janë sjelljet e tij, fjalët e tij. Emrat e dashur që u ka ngjitur fëmijëve kur i kishte të vegjël, mënyra se si i mbante për dore kur përshkonin rrugën bashkë, lëvizjet e gishtërinjve të tij mbi kokat e tyre kur u shkonte pranë. Edhe pse nuk isha më fëmijë prej kohësh, im atë do të ma kalonte gjithnjë me ngrohtësi dorën pas qafe për të më puthur. E ndiej ende mbi faqe të puthurën e tij. Ishte e puthura e veçantë e tim eti, që më donte. Dhe, meqë ishte mjek, përkujdesej nga afër për shëndetin tim, më mbronte, më fliste ngrohtësisht për jetën. Më tregonte histori që askush s'di t'i tregojë më mirë se ai.

Veprimet e tij i shoh e i ribëj edhe unë. Kur jam duke prekur një nga fëmijët e mi, shoh duart e tim eti mbi të miat. Edhe unë sajoj emra përkëdhelës për kolopuçët e mi, sikurse sajonte ai për mua. Në vesh kam shprehjet që ai përdorte, sharjet që nuk i kursente e që tani janë pa pikë kuptimi, por që atë e bënin të gajasej aq shumë. Edhe historitë që unë tregoj, i kam prej tij.

Ishte njeri i shëndoshë, mbresëlënës e dashamirës, fytyrën e kishte me nofulla të forta e sy shkrepitës. Gërhinte fort. Kur isha fëmijë, gjithmonë kisha frikë se mos zhdukej. Dhoma e prindërve të mi bashkohej me timen përmes një porte të dyfishtë. Të dielave unë zgjohesha para tyre. Hapja ngadalë derën e parë, vija

veshin te tjetra dhe pas një çasti dëgjoja gërhimën e tim eti. Nëna zgjohej dhe e linte në gjumë. Pas një farë kohe, hyja në dhomë, ulesha buzë krevatit dhe thosha: “Babi, zgjohu, shkoi ora dhjetë.” Prisja që ai të zgjohej. Ai çelte sytë dhe zgjaste dorën për të më prekur fytyrën, duke më thënë: “Mirëmëngjesi, xhan i babit.”

7. Cila prej alternativave të mëposhtme na tregon se pjesa është shkruar në vetën e parë, numri njëjës? **1 pikë**

- A) Ishte njeri i shëndoshë, mbresëlënës e dashamirës.
- B) Është shumë e rëndësishme të trashëgohet një emër.
- C) Ajo çka lë pas dikush, para së gjithash janë sjelljet e tij, fjalët e tij.
- D) Kur jam duke prekur një nga fëmijët e mi, shoh duart e tim eti mbi të miat.

8. Në fjalinë: “Në vesh kam shprehjet që ai përdorte, sharjet që nuk i kursente e që tani janë pa pikë kuptimi, por që atë e bënë të gajasej aq shumë”, fjala **gajasej** ka kuptimin: **1 pikë**

- A) shkrihej,
- B) mërzitej,
- C) shqetësohej,
- D) buzëqeshte.

9. Në këtë histori ne mësojmë rreth personazhit kryesor, përmes: **1 pikë**

- A) asaj që ai bisedon me babanë e tij.
- B) bisedave që ai bën me fëmijët e tij.
- C) çfarë ai mendon rreth babait të tij.
- D) mënyrës se si i zgjidh problemet e ndryshme.

10. Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon lidhjen mes asaj që ndodh në këtë pjesë dhe mënyrës së të treguarit? **1 pikë**

- A) Ai tregon ngjarje komike në mënyrë humoristike.
- B) Ai tregon ngjarje personale në mënyrë emocionuese.
- C) Ai tregon ngjarje të përditshme në mënyrë mbresëlënëse.
- D) Ai tregon ngjarje të jashtëzakonshme me vërtetësi.

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

11.

- a) Çfarë i ngacmon kujtimet e personazhit kryesor që lidhen me të atin? **1 pikë**

- b) Autori beson se e rëndësishme është që dikush të lërë pas sielljet e tij, fjalët e tij.

Tregoni, përmes dy shembujsh të marrë nga pjesa, se si shfaqen këto dy karakteristika në figurën e babait. **2 pikë**

- c) Identifikoni dy nga cilësitë e babait që i ka trashëguar edhe i biri. **2 pikë**

12.

- a) Pjesa është shkruar në vetën e parë, numri njëjës. Çfarë ka të veçantë kjo mënyrë e rrëfimit? **1 pikë**

- b) Autori thotë: "Kur isha fëmijë, gjithmonë kisha frikë se mos zhdukej babai." Si e interpretoni ndjesinë e fëmijës? **2 pikë**

13. Pjesa titullohet "Udhëtim në kohë". Zbuloni domethënien e titullit, duke u bazuar tek figura letrare e përdorur dhe përmbajtja e pjesës. **2 pikë**

14. Fëmijëria lë gjurmë në formimin e gjithsecilit. Shpjegoni si ka ndikuar fëmijëria tek autori, duke e ilustruar mendimin tuaj me shembuj nga pjesa. **3 pikë**



@matura.shteterore

PJESA III

15. Gjeni prapashtesën dhe mbaresën e fjalës *veprimet*. **2 pikë**

Prapashtesa: _____ Mbaresa: _____

16. Përcaktoni gjininë dhe rasën e emrit të nënvizuar. **2 pikë**

Pëlqen akulloren që ia japin në një tas qelqi.

Gjinia: _____ Rasa: _____

17. Qarkoni rastin kur fjala e nënvizuar është ndajfolje. **1 pikë**

- A) ... do të ma kalonte me ngrohtësi dorën pas qafe për të më puthur.
- B) ... përkujdesej nga afër për shëndetin tim.
- C) ... bashkohej me timen përmes një porte të dyfishtë.
- D) ... ulesha buzë krevatit dhe thosha...

18. Ndërtoni një fjali ku të përdorni mbiemrin i shëndoshë në shkallën krahasore të barazisë. **1 pikë**

19.

a) Përcaktoni vetën dhe rasën e trajtës së shkurtër të përdorur në fjalinë e mëposhtme. **2 pikë**
Në vesh kam shprehjet që ai përdorte, sharjet që nuk i kursente e që tani janë pa pikë kuptimi.

Veta: _____ Rasa: _____

- b) Foljen e fjalisë së mëposhtme vendoseni në mënyrën habitore, koha më se e kryer (pa ndryshuar kategoritë e tjera). **1 pikë**

Dhoma e prindërve të mi bashkohej me timen përmes një porte të dyfishtë.

20.

- a) Gjeni kryefjalën në fjalinë e mëposhtme. Tregoni me se shprehet. **2 pikë**

Atë ditë, im atë nuk e dinte që do të kisha edhe pesë fëmijë të tjerë pas saj.

Kryefjala: _____ Shprehet me: _____

- b) Me se shprehet kundrinori i drejtë në fjalinë e dhënë? **1 pikë**

Pranë tij, një vogëlushe me sy të kafenjtë, të mëdhenj, që vështron gjithçka.

Shprehet me: _____

21.

- a) Me foljen *hap* ndërtoni grupe foljore që shprehin një herë rrethanë shkaku dhe një herë rrethanë mënyre. **2 pikë**

Rrethanë shkaku: _____ Rrethanë mënyre: _____

- b) Gjeni kallëzuesin emëror në fjalinë e mëposhtme dhe tregoni nga se është i përbërë. **2 pikë**

Dhe, meqë ishte mjek, përkujdesej nga afër për shëndetin tim, më mbronte, më fliste ngrohtësisht për jetën.

Kallëzuesi: _____ Përbërë nga: _____

22. Qarkoni fjalinë e përbërë. **1 pikë**

- A) E shoh të ulur, me një rën dorë mbi kofshë dhe tjetrën mbi tryezë.
- B) E ndiej ende mbi faqe të puthurën e tij.
- C) Veprimet e tij i shoh e i ribëj edhe unë.
- D) Edhe historitë që unë tregoj, i kam prej tij.

23. Qarkoni alternativën ku është përdorur përemri dëftor. **1 pikë.**

- A) ...duart e tim eti.
- B) ...i sajonte ai për mua.
- C) ...atë ditë nuk e dinte.
- D) ...i kam prej tij.

24. Në cilën alternativën është përdorur fjalia e përbërë filluese? **1 pikë**

- A) Im atë nuk e dinte që do të kisha edhe pesë fëmijë të tjerë pas saj.
- B) Emrat e dashur që u ka ngjitur fëmijëve kur i kishte të vegjël.
- C) Në vesh kam shprehjet që ai përdorte, sharjet që nuk i kursente.
- D) Ishte e puthura e veçantë tim eti, që më donte.



@maturore

25. Të shkruajmë

6 pikë

Ndodh që disa njerëz sakrifikojnë ose heqin dorë nga diçka shumë e rëndësishme për një arsye të fortë.

Përshkruani një periudhë, kur ju vendosët të hiqni dorë nga diçka për një arsye të mirë. Shpjegoni çfarë ndodhi, pse e morët këtë vendim dhe si u ndjetë pas kësaj.



@matura.shteterore

Shtjellimi i idesë (25a)	Struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (25d)	Totali
2	1	1	2	6 pikë

MODELI V



@maturashitetere

PJESA I

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Një udhëtim në “Çatinë e botës”

Vite më parë, pata fatin të shkoja në Tibet, një vend i vogël i rrethuar nga të gjitha anët me male gjigante, majat e të cilave zbardhin nga dëbora. Për mijëra vjet, këto male kanë shërbyer si mburojë, duke mos lejuar njerëz të huaj që të hynin në brendësi të vendit. Kjo është një prej arsyeve që kërkuesit dhe shkrimtarët e kanë quajtur Tibetin si “Çatia e botës”. Është i vështirë për t'u arritur! Një arsye tjetër është lartësia e Tibetit, se, kur arrin në 5600 metra mbi nivelin e detit, nuk mund të mbushesh dot me frymë.

Më parë tibetianët ishin nomadë, njerëz pa një vendbanim të përhershëm. Toka në Tibet është shumë shkëmbore dhe nuk mund të rriten bimë, prandaj njerëzit e përqendruan jetën e përditshme dhe mbijetesën tek jakët². Kjo kafshë u siguronte atyre, thuajse, gjithçka që u nevojitej: qumësht, mish dhe lesh për rrobat dhe litarët. Edhe plehu i tyre përdorej për zjarr. Nomadët tibetianë i udhëhiqnin tufat e kafshëve përmes kullotave, luginave, shpateve të maleve në kërkim të tokave më të pasura. Ata nuk jetonin në shtëpi të përhershme të bëra me dru, tulla apo gurë. Tashmë kohët kanë ndryshuar në Tibet dhe gjithnjë e më shumë njerëzit po jetojnë në fshatra dhe qytete. Por ende ka nomadë, të cilët jetojnë në pllaja të larta, ashtu si të parët e tyre dikur.

Të jetosh si një nomad modern

... Bashkë me disa miq dhe mësuesin tonë, Didomin, po udhëtonim drejt Khamit, pjesa lindore e Tibetit. Didomi kishte lindur në Tibet dhe kishte jetuar vitet e para të jetës si një nomad tradicional. Për shkak të problemeve politike, kur ishte ende i ri, familjes së tij iu desh të lëvizte për në Indi. Ne e shoqëruam Didomin për në vendlindje, për të provuar “shijen” e jetës së lashtë nomade, por me disa ndryshime të vogla moderne, sepse ne kishim makina - një luks që nomadët nuk e kishin provuar.

Kur vjen koha që një familje nomade duhet të lëvizë, ajo i paketon gjërat e saj dhe ua ngarkon jakëve. Një familjeje tipike mund t'i nevojiten 30 deri në 50 jakë për

² Jak ~ Iloj kafshë që përdoret në Tibet për punë, ushqim dhe si lëndë e parë për veshmbathje.

të transportuar të gjitha pajisjet, kurse ne i vendosëm të gjitha gjërat tona brenda një autobusi me katër rrota.

Probleme gjatë rrugës

Nëse do që të kalosh përmes një vendi të ashpër, jakët janë vërtet njohës të shkëlqyer të terrenit. Shumë herë nomadëve u duhet të kalojnë përmes lumenjve të rrëmbyer, por ky nuk është aspak problem për jakët besnikë dhe të vendosur. Një ditë, kur donim të kalonim një lumë, makina jonë me katër rrota nuk dukej dhe aq e besueshme. Duke udhëtuar, ne ngecëm në baltinat e lumit dhe u deshën një duzinë me njerëz për ta shtyrë dhe për ta lëvizur nga vendi...

Kur arrijnë në destinacion, nomadët i ngrenë tendat e tyre brenda disa minutash, ndërsa unë dhe miqtë e mi, me çadrat tona moderne, nuk ishim dhe aq të shpejtë. Në një nga vendqëndrimet tona, më kujtohet se u përpoqëm shumë për ta ngritur çadrën si duhet. Disa fëmijë nomadë na u afruan duke buzëqeshur dhe na ndihmuan ta ngrinin në çast, edhe pse nuk kishin parë kurrë një çadër të tillë.

Është ftohtë atje lart!

Moti në Tibet është i ftohtë dhe era mizore fryn pa mëshirë, por, nëse qëndron brenda një çadre nomade, nuk e ndien atë. Të pëlqen kur shikon zjarrin që digjet në sobën e tyre prej balte dhe ndien ngrohtësi e rehati pranë tij, por nuk mund ta them këtë për çadrën moderne, ku fjeta bashkë me miqtë e mi. Më kujtohet se si një natë, duke dëgjuar shiun e akullt që godiste anët e çadrës, dridhesha nga të ftohtët, edhe pse isha mbuluar me kuvertë dhe kisha veshur katër bluza e tri palë pantallona.

Mënyra e duhur

Në këtë udhëtim mësova se për të mbijetuar të duhet jo vetëm një çaj miqësor, por edhe një çadër e ngrohtë dhe e sigurt, pra gjithçka duhet në mënyrën e duhur. Kudo ku udhëtuam, tibetianët ishin njerëz miqësorë, të lumtur dhe kureshtarë: mund të ishte dikush që ngrohte duart e mia të ngrira, mund të ishte një familje që pushonte një çast për të kërcyer dhe për të kënduar në një rreth apo mund të ishte një grup fëmijësh që më shikonin me buzëqeshjet e tyre të ngrohta. Megjithëse jeta e tyre është plot me sfida, nomadët kurrë nuk i marrin shumë seriozisht problemet e jetës së tyre të përditshme. Ata e dinë se sa të përkohshme janë gjërat, përfshi edhe shtëpitë e tyre. Ne mësuam disa gjëra prej tyre. Ndoshta, kur të kalojmë

lumenjtë e vrullshëm apo të përballemi me ditë të acarta, do ta bëjmë atë në mënyrën e duhur..., me të njëjtën mënyrë që buron edhe buzëqeshja e çiltër e nomadëve tibetianë.

1. Pse autori me miqtë e tij vendosën të udhëtojnë me Didomin? **1 pikë**

- A) Sepse ai ishte mik me shumë familje vendase tibetiane.
- B) Sepse ai mund t'i mësonte ata të komunikonin me nomadët.
- C) Sepse ai mund t'u tregonte jetën nomade që kishte jetuar në Tibet.
- D) Sepse ai mund t'u tregonte se si të shmangnin vështirësitë e udhëtimit.

2. Çfarë do të na thotë autori, kur i përshkruan jakët si **njohës të shkëlqyer të terrenit**? **1 pikë**

- A) Jakët nuk kanë frikë nga terreni i ashpër.
- B) Jakët janë shumë miqësorë dhe të dashur.
- C) Jakët u sigurojnë nomadëve çdo gjë që u nevojitet.
- D) Jakët ia dalin shumë mirë në terrenin e vështirë tibetian.

3. Përse autori na tregon ngjarjen që lidhet me vështirësitë për ngritjen e çadrës së tij? **1 pikë**

- A) Për të na treguar se kishte blerë një çadër më të mirë se tibetianët.
- B) Për të na demonstruar vështirësitë kur punon në një klimë të ashpër.
- C) Për të na thënë se do të donte shumë të kishte një çadër tibetiane.
- D) Për të na dhënë një shembull të aftësive dhe të bujarisë së të rinjve tibetianë.

4. Cila nga fjalitë e tekstit shpjegon më mirë, pse Tibeti është quajtur "**Çatia e botës**"? **1 pikë**

- A) Kur arrin në lartësinë 5600 metra mbi nivelin e detit, nuk mund të mbushesh dot me frymë.
- B) Por ende ka nomadë, të cilët jetojnë në pllaja të larta, ashtu si të parët e tyre dikur.
- C) Por, kur na u desh të kapërcenim një lumë, makina jonë me katër rrota nuk dukej dhe aq e besueshme.
- D) Moti në Tibet është i ftohtë dhe era mizore fryn pa mëshirë, por, nëse qëndron brenda një çadre nomade, nuk mund ta ndiesh atë.

5. Si është strukturuar ky artikull? **1 pikë**

- A) Me një vëzhgim të jetës së një grupi nomadësh.
- B) Me disa pjesë të shkurtra që bazohen në çështje specifike.
- C) Duke na prezantuar disa vëzhgime sipas një rendi kronologjik.
- D) Duke vënë përballë aspektet pozitive dhe negative të jetës nomade.

6. Cila nga alternativat e mëposhtme është **përmbledhja më e mirë** e këtij artikulli? **1 pikë**

- A) Në udhëtimin e tij në Tibet, autori zbuloi se, megjithëse, shumë tibetianë kanë lëvizur drejt qyteteve, ka ende shumë që pëlqejnë jetën nomade. Ata nuk jetojnë në shtëpi të përhershme, por lëvizin përgjatë gjithë vendit. Çadrat e tyre janë shumë më të ngrohta se çadra moderne e autorit.
- B) Gjatë vizitës së tij në Tibet, autori mëson se moti në këtë vend është shumë i ashpër. Megjithatë, nomadët tibetianë vazhdojnë të ndjekin mënyrat e vjetra të jetesës, duke rritur jakë për nevojat e tyre. Gjatë lëvizjeve nga një vend në tjetrin, atyre shpesh u duhet të kalojnë lumenj të rrezikshëm dhe terrene të ashpra. Megjithatë, ata kanë një qëndrim të mrekullueshëm ndaj jetës.
- C) Kur autori udhëton me miqtë e tij në Tibet, ai mëson se shumë tibetianë vazhdojnë të jetojnë si nomadë. Ata ndjekin zakonet e vjetra të rritjes së jakëve, të cilët i ndihmojnë të lëvizin nga një vend në tjetrin, si dhe u sigurojnë nevojat themelore të jetesës. Megjithëse jeta e nomadëve shfaq shumë vështirësi, ata i pranojnë gjërat ashtu siç janë dhe kjo i bën të ndihen të lumtur.
- D) Gjatë udhëtimit në Tibet, autori pa se nomadët tibetianë kanë mësuar se si të mbështeten te jakët për të mbijetuar. Ata marrin ushqime, rroba, strehë dhe ngrohje prej këtyre kafshëve, të cilat janë shumë miqësore. Sipas tij, ato janë njohëse të shkëlqyera të terrenit, për shkak të aftësisë së tyre për t'i kaluar lumenjtë pa asnjë problem. Në një moment jakët ishin shumë më të dobishëm se sa makinat.

7.

- a) Identifikoni në këtë pjesë dy momente ku aftësitë e tibetianëve ua kalojnë atyre të vizitorëve. **2 pikë**

- b) Si mendoni, cila është arsyeja që autori ka dhënë këto momente? **1 pikë**

8.

- a) Tibetianët nomadë janë njerëz që bëjnë një jetë të vështirë, por ndërkohë ndihen të lumtur dhe janë miqësorë me të tjerët. Shpjegoni pse ndodh kjo. **2 pikë**

- b) Çfarë mësoi autori dhe miqtë e tij nga mënyra e jetesës dhe e sjelljes së tibetianëve nomadë? **1 pikë**



@matura.shqiperore

PJESA II

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Bora

Ah, ato ditë bore! Ç'ndryshim të menjëhershëm shkaktonin te ne, përreth nesh!... E, ç'fërgëllimë gazmore pushtonte bankat e klasës, që me rënien e flokëve të para! Drita zbehej. Gjithçka bëhej e marrtë³: suvaja e fasadave vishej me ngjyrë të përhimët, të zbërdhulët e pemët dukeshin më të zeza. Pa e ditur pse, vetë shkumësi humbiste ndër gishtat tanë shkëlqimin e vet, rrezatimin e vet. Kishim përshtypjen se një çast solemn po na afrohej.

Jashtë, kur ngrinin kryet përpjetë, gati sa s'deheshim nga gëzimi, tek na sulleshin fytyrës, pa ditur ku shkonin, ato mijëra bletëza bardhake, që me të ftohtit e tyre na pickonin fytyrës me një saktësi aq të fshehtë, aq të ëmbël, sikur ta kishin zgjedhur enkas vendin e uljes, në tërë atë vorbullimë që kishin bërë. Qielli nuk qe më i përhimët; ishte i kuqërremtë, i lëbyrtë. E ca nga ca, kangjellat e kolegjit, degët, stolat, çatitë ktheheshin në të tjera kangjella, në të tjera degë, në të tjera stola, në të tjera çati. Sipas drejtimit të erës, bora vërsulej mbi një gardh a mbi një mur gjysmë të rënë e nga pas veç shquanim një hapësirë të zbrazët, ende të paprekur. Por era nuk zgjaste tërë kohën. Atëherë, bora binte më rrëmbyeshëm e mbulonte gjithçka me bardhëllimën e vet pushatore, sikur të kishte pritur, pikërisht, këtë çast pavëmendshmërie për t'u ulur si perandoreshë, për të depërtuar deri edhe te boshllëqet e kanatave, nën tulla, nën mushamatë e karrocave, nën hangarë, madje edhe qosheve të pullazinave, duke hyrë përmes një xhami të thyer. Në mesditë kur bora të mos kishte reshtur, e dinim se orët e mësimi do të kalonin pa më të voglën mërzë, sikur të avullonin se, edhe vetë mësuesi do të vështronte hera-herës, nëse ajo do të binte apo nëse vijonte të binte. Ajri krejt ishte mbushur me vetë mrekuillinë. E mësuesi thoshte:

- Shih, po mban... Po arrin njëzet centimetra lartësi.

E çuditshme: as që e kishim llogaritur. Për ne mjaft që ajo ishte atje, kudo e pranishme, që telat e telefonit epeshin nën peshën e saj, që asgjë nga jeta të mos na shfaqej nën këndin e vet të zakonit, që, kur ndërronim trotuar, hapat të na kërcisnin nga pas, si të ishim duke

³ E marrtë~ e zbehtë, e turbullt.

ndjekur vetveten. Të nesërmen ajo ndriste e tëra me reflektimin e vet të fortë, të ftohtë gjer në qoshet më të errëta.

Një palëvizshmëri tragjike pllakoste mbi fshat. Trumcakët cicëronin, kruspulloseshin në parvaze të dritareve

a hophopeshin mes pingërimesh⁴ të vockla para portave të pastruara prej dëborës.

Kudo heshtje. Duke kaluar nëpër pemë, më dukej sikur isha përpirë krejt nga një botë e tërë flore nëndetare, në një nga ato humbëtira të thella, ku korale algash, polipera⁵ shpalosin fuqimisht degëzimet e tyre të dendura, plot degë të rënduara nga ngrica. Loja dhe rrëshqitja vinin më pas dhe ne ua hiqnim kësisoj gjërave atë pamje të pambuktë, të përgjumur, të mpirë që shpesh më bënte të ndihesha në një botë të panjohur, ku përjetoja ditë aq pak të shkurtra.

9. Në fjalinë “E ç’fërgëllimë gazmore pushtonte bankat e klasës!...”, fjala **fërgëllimë** ka kuptimin? **1 pikë**

- A) dridhje,
- B) tendosje,
- C) britmë,
- D) D) dëshirë

10. Cila nga fjalitë e mëposhtme përshkruan më mirë temën e kësaj pjese? **1 pikë**

- A) Kujtimet shpesh të ngjallin nostalgji.
- B) Natyra të krijon emocione të pabesueshme.
- C) Edhe jeta në shkollë ka të papriturat e veta.
- D) Është e rëndësishme të kërkosh përvoja të reja.

⁴ Pingërim ~ cicërimë

⁵ Polipera~ forma që marrin në një fazë të caktuar të ciklit të jetës knidarët (grup invertebrorësh).

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

11. Në cilën prej alternativave të mëposhtme mbiemri është përdorur në mënyrë figurative? **1 pikë**

- A) Qielli nuk qe më i përhimët.
- B) Përjetoja ditë aq pak të shkurtra.
- C) Ne ua hiqnim gjërave atë pamje të përgjumur.
- D) Duke hyrë përmes një xhami të thyer.

12. Në ç'përfundim arrin lexuesi, për autorin e kësaj pjese? **1 pikë**

- A) Autorit i pëlqen harmonia që ka klasa ku mëson.
- B) Autorit i pëlqen vetëm ta kundrojë dëborën që bie.
- C) Autorit nuk i pëlqen që loja e fëmijëve ia heq bukurinë dëborës.
- D) Autori tregon një vëmendje të madhe ndaj efekteve që shkakton dëborë kudo.

13. Çfarë përfaqëson bora në këtë pjesë? **1 pikë**

- A) Një ndjesi kontrolli dhe besimi.
- B) Një lidhje të nxënësve me mësuesin.
- C) Ndjesinë e kohës që ikën pa kthim.
- D) Një mundësi për përjetime të thella dhe argëtim.

14.

a) Në fillim të kësaj historie autori shkruan: "Ah, ato ditë bore! Ç'ndryshim të menjëhershëm shkaktonin tek ne, përreth nesh!..." Cilave ndryshime u referohet ai? **2 pikë**

b) Autori nuk e kupton pse pemët i dukeshin më të zeza (paragrafi I). Si mendoni, pse i krijohet ky përfytyrim? Shpjegoni përgjigjen tuaj. **2 pikë**

- c) Cili është përfytyrimi që ju krijohet përmes krahasimit në fjalinë e mëposhtme? Shpjegoni përgjigjen tuaj.
...sikur të kishte pritur pikërisht këtë çast pavëmendshmërie për t'u ulur si perandoreshë. **2 pikë**

15. Duke iu referuar paragrafit të fundit, tregoni pse autori mendon se ardhja e fëmijëve do të ndryshonte gjithçka. Përdorni shprehje ose detaje nga paragrafi për të mbështetur përgjigjen tuaj. **2 pikë**



@matura.shteteror

PJESA III

16. Gjeni rrënjën e fjalës *kruspulloseshin*. Thoni cilës klasë i përket rrënja që gjetët. **2 pikë**

Rrënja: _____ Klasa: _____

17. Gjeni një çift sinonimik në paragrafin e parë. **1 pikë**

18.

- a) Tregoni shkallën e ndajfoljes në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**

Bora binte më rrëmbyeshëm e mbulonte gjithçka me bardhëllimën e vet pushatore.

Shkalla: _____

- b) **Nga** përdoreni në fjali një herë si *parafjalë* dhe një herë si *lidhëz*. **2 pikë**

Si parafjalë: _____

Si lidhëz: _____

19.

- a) Tregoni mënyrën dhe kohën e foljes së nënvizuar. **2 pikë**

E dinim se orët e mësimi do të kalonin pa më të voglën mërzi.

Mënyra: _____ Koha: _____

GJUHA SHQIPE DHE MATEMATIKA

- b) Tregoni vetën dhe rasën e trajtës së shkurtër të përdorur në fjalinë e mëposhtme. **2 pikë**

Ato mijëra bletëza bardhake, që me të ftohtit e tyre na pickonin fytyrës me një saktësi aq të fshehtë.

Veta: _____ Rasa: _____

- c) Qarkoni përemrin që është futur gabim sipas llojit. **1 pikë**

- A) shkëlqimin e vet;
- B) peshën e saj;
- C) të ftohtët e tyre;
- D) kangjella të tjera.

20. Tregoni funksionin e formës së pashtjelluar përcjellore në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**

Duke kaluar nëpër pemë, më dukej sikur isha përpirë krejt nga një botë e tërë flore nëndetare.

Funksioni: _____

21. Tregoni trajtën dhe rasën e emrit të nënvizuar. **2 pikë**

Ah, ato ditë bore!

Trajta: _____ Rasa: _____



@matjura.shteterore

22.

- a) Rishkruani fjalinë duke vendosur kryefjalën në numrin shumës. Bëni ndryshimet e duhura. **1 pikë**

Të nesërmen, ajo ndriste e tëra gjer në qoshtet më të errëta.

- b) Gjeni kundrinorin e drejtë në fjalinë e mëposhtme Thoni me se është shprehur. **2 pikë**

Në mesditë, kur bora të mos kishte reshtur, edhe vetë mësuesi do të vështronte hera-herës, nëse ajo do të binte

Kundrinori i drejtë: _____

Shprehur me: _____

23. Qarkoni alternativën ku është përdorur fjalia përcaktore. **1 pikë**

- A) Për ne mjaftonte që ajo ishte atje, kudo e pranishme.
B) Mësuesi do të vështronte hera-herës nëse ajo do të binte.
C) Kishim përshtypjen se një çast solemn po na afrohej.
D) E çuditshme: as që e kishim llogaritur.

24. Rishkruani fjalinë duke kthyer grupin emëror me shkronja të pjerrëta në pjesë të nënrenditur kohore. **1 pikë**

E, ç'fërgëllimë gazmore pushtonte bankat e klasës, që me rënien e flokëve të para!

25. Të shkruajmë

6 pikë

Gjërat e bukura, pavarësisht se për sa kohë zgjatin, krijojnë emocione mbresëlënëse.

Bazuar edhe në pjesën “Bora”, shpjegoni vërtetësinë e kësaj thënieje.



@matura.shteterore

Shtjellimi i idesë (25a)	Struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (25d)	Totali
2	1	1	2	6 pikë

MODELI VI



@maturoshitetore

PJESA I

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Kulla e Pizës

Qyteti i Pizës ndodhet në rajonin e bukur të Toskanës, në qendër të Italisë. Piza është e njohur për strukturat e saj të mëdha prej mermeri të bardhë. Struktura më e famshme është Kulla e Pizës. Ndërtimi i saj nisi në vitin 1173 dhe përfundoi rreth vitit 1370. Ajo është një kullë elegante, tetëkatëshe, në majë të së cilës ndodhet një kabanë dhe një shkallare e brendshme në formë spiraleje me rreth 300 shkallë. Harqet dhe kolonat i japin asaj një pamje dinjitoze.

Në kohën kur ndërtimi i kullës kishte arritur në katin e tretë dhe të katërt, u pa qartë se ajo do të ishte një strukturë e jashtëzakonshme. Por u vërejt diçka: kulla kishte filluar të anohej. Arkitektët u përpoqën ta ndreqnin problemin gjatë ndërtimit të kateve që kishin mbetur, por struktura vazhdonte të anohej. Atëherë ata e vendosën kabanën nga ana e veriut për të krijuar një lloj ekuilibri. Mirëpo kulla vazhdonte sërish të anohej.

Gjatë shekujve përpjekjet janë përqendruar më shumë në gjetjen e një mundësie për të parandaluar animin e mëtejshëm të kullës. Në vitin 1934 u bënë përpjekje për ta stabilizuar strukturën, duke derdhur beton në themelet e saj të gurta, por ajo dështoi dhe kulla vazhdonte të anohej edhe më shumë. Ka pasur shumë ide për mirëmbajtjen, madje disa edhe të çuditshme. Një komision ndërkombëtar sugjeroi që të fiksohej një balonë me helium në majën e saj për ta mbajtur lart, por ky sugjerim nuk u zbatua kurrë.

Sërish kulla vazhdonte të anohej. Në vitin 1990 ekspertët vunë re që ajo ishte seriozisht e rrezikshme dhe shumë pranë rrëzimit, prandaj u ndalua hyrja për publikun. Një komision ndërkombëtar, i përbërë nga historianë dhe specialistë, filloi përpjekjet për shpëtimin e kullës. Ata arritën në përfundimin se dheu në anën jugore të saj ishte më i butë se në anën veriore dhe pesha e kullës prej mermeri po e përshpejtonte zhvendosjen. Për të ngadalësuar lëvizjen e kullës, u instaluan kablllo prej çeliku dhe u vendosën kundërpesha për stabilizimin e saj. Në të njëjtën kohë, një sasi e madhe dheu u hoq nga pjesa veriore për të niveluar tokën ku mbështetej kulla. Këto përpjekje për të mbrojtur dhe mirëmbajtur kullën nuk janë dhe aq të dukshme për një sy të pastërvitur: kulla sërish duket e anuar.

Komisioni ndërkombëtar dhe qytetarët krenarë të Pizës janë plot shpresë nga përpjekjet e fundit për të ndaluar animin e saj. Ekspertët besojnë se kulla do të jetë

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

e qëndrueshme për të paktën 300 vitet e ardhshme. Nëse ajo do të anohet shumë më tepër, me siguri që arkitektët dhe historianët sërish do të vijnë me ide të reja për të shpëtuar kullën e mrekullueshme të Pizës.

1. Autori e shkroi këtë pjesë kryesisht: **1 pikë**

- A) për të përshkruar përpjekjet për të ndaluar rënien e Kullës së Pizës.
- B) për të bindur njerëzit se ia vlen të shpëtohet Kulla e Pizës.
- C) për të demonstruar pse është e rrezikshme të vizitohet nga brenda Kulla e Pizës.
- D) për të shpjeguar pse kanë dështuar përpjekjet e hershme për ta mirëmbajtur Kullën e Pizës.

2. Cili detaj shpjegon pse një nga përpjekjet për të stabilizuar animin e kullës bëri që ajo të anohej edhe më shumë? **1 pikë**

- A) Kabllot dhe pesha u instaluan për të stabilizuar animin e kullës.
- B) Kulla vazhdoi të anohej edhe pasi kambana u vendos në anën veriore të kullës.
- C) Një rrjedhje betoni bëri që themelet e kullës të ishin akoma më shumë të paqëndrueshme.
- D) Dheu u lëviz nga pjesa veriore e kullës për ta bërë atë edhe më shumë të qëndrueshme.

3. Cila nga fjalitë e mëposhtme (të marra nga teksti) është një opinion i autorit të kësaj pjese? **1 pikë**

- A) Në vitin 1990 ekspertët vunë re që kulla ishte seriozisht e rrezikshme dhe shumë pranë rrëzimit, prandaj u ndalua hyrja për publikun.
- B) Një komision ndërkombëtar sugjeroi që në majën e saj të fiksohej një balonë me helium për ta mbajtur lart, por ky sugjerim nuk u zbatua kurrë.
- C) Një komision ndërkombëtar, i përbërë nga historianë dhe specialistë, filloi përpjekjet për shpëtimin e kullës.
- D) Nëse kulla do të anohet shumë më tepër, me siguri që arkitektët dhe historianët sërish do të vijnë me ide të reja për të shpëtuar kullën e mrekullueshme të Pizës.

4. Cilën nga idetë e mëposhtme mbështet paragrafi i dytë? **1 pikë**

- A) Kulla ishte e vështirë për t'u ndërtuar pa teknologjinë moderne.
- B) Problemi me kullën ishte i dukshëm që kur filloi të ndërtohej.
- C) Shtesa në pjesën e kamberës bëri që kulla të anohej edhe më shumë.
- D) Ndërtimi i kullës ishte një proces që zgjati më shumë se sa parashikohej.

5. Lexuesi në fund mund të arrijë në përfundimin se kulla ka shumë të ngjarë: **1 pikë**

- A) të ketë nevojë të monitorohet dhe të mirëmbahet për aq kohë sa vazhdon të qëndrojë.
- B) të jetë sërish në pozicion të drejtë, duke përdorur teknologji të së ardhmes.
- C) të jetë edhe më shumë madhështore, ndërsa vazhdon të anohet.
- D) të ndihmojë ekspertët që të zgjidhin probleme strukturore me ndërtesat e tjera.

6.

a) Sipas këtij artikulli, cila është arsyeja kryesore që Kulla e Pizës anohet vazhdimisht? **1 pikë**

b) Sipas mendimit tuaj, çfarë e bën kaq të veçantë Kullën e Pizës: pamja e saj apo historia që e shoqëron që nga krijimi? Argumentoni mendimin tuaj. **2 pikë**

PJESA II

Lexoni pjesën e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Ishulli i Delfinëve Blu

Kjo është historia e një vajze indiane, e cila mbijetoi e vetme për shumë vite me radhë në një nga ishujt e Oqeanit Paqësor.

Në mëngjes, mes zhurmës shurdhuese të elefantëve të detit që s'kishte të pushuar, u nisa për t'u kthyer te kepi.

Kishte edhe një vend tjetër të përshtatshëm ku mund të ndërtoja strehimin tim: pranë fshatit të shkatërruar Ghalasat; por nuk dëshiroja të shkoja atje, sepse do të më kujtoheshin orë e çast njerëzit e mi që ishin larguar prej andej me anijen me vela të bardha, si dhe ata që kishin vdekur. Në atë vend edhe era frynte shumë fort duke përmbysur dunat, edhe rëra fluturonte gjithandej duke depërtuar kudo. Kjo ishte shumë e bezdisshme.

Atë natë ra shi dhe qielli rrodhi për dy ditë rresht. Për t'u mbrojtur, sajova një strehë në rrëzë të shkëmbit dhe hëngra ushqimin e ruajtur te shporta. Për shkak të shiut nuk kisha mundësi të ndizja zjarr, ndaj vuajta shumë nga të ftohtët.

Ditën e tretë, kur përmytja u fashit, dola të kërkoja të gjitha ato gjëra që do të më duheshin për të filluar ndërtimin e strehimit tim. Para së gjithash, më nevojiteshin disa purteka për thyerjen e gardhit, sepse doja t'i vrisja qentë e egër sa më shpejt. Por në ishull kishte edhe mjaft dhelpra të vogla të kuqe, dhe ishin aq shumë, sa nuk mund të shpëtoja prej tyre, veçse duke përdorur më tepër kurthet sesa shigjetat.

Ato ishin dinake dhe hajdute shumë të shkathëta dhe, nëse nuk do të dija të ndërtoja një gardh të fortë, do ta kisha të pamundur të ruaja qoftë edhe një guaskë të vetme albalonesi.

Pas shiut të pandërprerë, mëngjesi gdhui i freskët e i kthjellët dhe kundërmimi që lëshonin pellgaçet e mbetura nga batica, ishte i fortë. Nga përrënjtë ngriheshin erëhimet e ëmbla të barishteve të harlisura.

Kur nisa të ecja nëpër shtegun që të çonte në ranishtë, ndihesha gjithë gëzim; fillova të këndoja me zë të lartë nëpër cekëtinën që rrihte dielli deri në rrafshinën me rërë. E ndieja se ajo ditë ishte për mua shenjë e fatit të mirë.

Ishte një ditë e mbarë për të filluar ndërtimin e shtëpisë sime të re.

7. Në fjalinë: "... kur përmytja u fashit...", fjala **u fashit** ka kuptimin: **1 pikë**

- A) u ul,
- B) u kthye,
- C) u zhduk,
- D) u përforcua.

8. Cila nga fjalitë e mëposhtme përshkruan më mirë personazhin kryesor? **1 pikë**

- A) Asaj i pëlqejnë aventurat në natyrë.
- B) Ajo ka dëshirë t'i bëjë të tjerët të ndihen krenarë.
- C) Ajo mendon se puna e saj është sfiduese.
- D) Ajo përballet me zgjuarsi me çdo lloj vështirësie.

9. Që vajza të ruhet nga dhelprat, duhet: **1 pikë**

- A) të ndërtojë një rrethim të sigurt.
- B) të ndërtojë një strehim larg tyre.
- C) të ndërtojë më shumë shigjeta.
- D) të mbledhë ushqim edhe për to.

10. Kjo pjesë trajton temën: **1 pikë**

- A) e dëshirës për të eksploruar të panjohurën.
- B) e kurajës për t'u përballur me rrezikun.
- C) e mbijetesës në kushte ekstreme.
- D) e respektit për botën natyrore.

11.

a) Vajza ka shumë pengesa që e vështirësojnë jetesën e saj në ishull. Identifikoni dy prej tyre. **2 pikë**

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

- b) Gjeni dy arsye pse vajza nuk dëshiron ta ndërtojë strehën e saj në fshat. **2 pikë**

- c) Çfarë e bezdis vajzën në lidhje me dhelprat? **1 pikë**

- d) Si është gjendja shpirtërore e vajzës në fund të kësaj pjese? Çfarë e shkakton këtë gjendje? **2 pikë**

- 12.** Kush e rrëfen këtë histori? Nga e kuptoni këtë? **2 pikë**

- 13.** Cili është përfytyrimi që keni krijuar për vajzën? Pse? Mendimin tuaj mbështeteni me ilustrime nga pjesa. **3 pikë**

14. Dy njerëz që e kanë lexuar këtë pjesë, bisedojnë me njëri-tjetrin. I pari thotë: “Më duket e pamundur që një vajzë e vogël t’ia dalë e vetme në një ishull. Kjo histori është thjesht një trillim”. I dyti thotë: “Jo, nuk mendoj kështu. Më duket shumë normale që dikush t’ia dalë i vetëm”.

Si mendoni ju, a mund t’ia dalë dikush i vetëm në ato rrethana?

Shpjegoni përgjigjen tuaj, duke treguar se e keni kuptuar domethënien e pjesës.

2 pikë



@matura.shteterore

PJESA III

15.

- a) Cilës klasë i përket fjala e nënvizuar? **1 pikë**

Atë natë ra shi dhe qielli rrodhi për dy ditë resht.

- b) Nga cila fjalë e ka prejardhjen emri *strehimin*? **1 pikë**

16. Qarkoni përemrin që është futur gabim sipas llojit. **1 pikë**

- A) Ato gjëra,
B) Ato ishin dinake,
C) Atë natë,
D) Ata që kishin vdekur.

17.

- a) Tregoni rasën e parafjalës së përdorur në fjalinë: **1 pikë**

Për shkak të shiut nuk kisha mundësi të ndizja zjarr.

- b) Tregoni vetën dhe rasën e trajtës së shkurtër. **2 pikë**

Doja t'i vrisja qentë e egër sa më shpejt.

veta: _____ rasa: _____

GJUHA SHQIPE DHE MATEMATIKA

18. Në fjalinë "Ishte një ditë e mbarë për të filluar ndërtimin e shtëpisë sime të re", tregoni gjymtyrën që përcakton fjala të re. **1 pikë**

19. Vendosni mbiemrin në shkallën krahasore të barazisë, duke plotësuar anën tjetër të krahasimit. **1 pikë**

Mëngjesi gdhiu i freskët... _____

20. Tregoni mënyrën dhe kohën e foljes. **2 pikë**

Ato gjëra që do të më duheshin për të filluar ndërtimin e strehimit tim,

mënyra: _____ koha: _____

21.

- a) Rishkruani fjalinë duke e vendosur kryefjalën në numrin shumës. Bëni ndryshimet e duhura. **1 pikë**

Në atë vend edhe era frynte shumë fort duke përmbysur dunat.

- b) Përcaktoni llojin e kallëzuesit. Tregoni me se është shprehur. **2 pikë**

Kjo ishte shumë e bezdisshme.

lloji: _____ shprehur me: _____



@matura.shteterore

22.

- a) Cili është funksioni i fjalës së nënvizuar? **1 pikë**

Para së gjithash, më nevojiteshin disa purteka për thyerjen e gardhit.

Funksioni: _____

- b) Rishkruani fjalinë në mënyrë të tillë që theksi logjik të bjerë te kundrinori i drejtë. **1 pikë**

Sajova një strehë në rrëzë të shkëmbit.

23. Qarkoni fjalinë e përbërë. **1 pikë**

- A) Ato ishin dinake dhe hajdute shumë të shkathëta.
B) Pas shiut të pandërprerë, mëngjesi gdhui i freskët e i kthjellët.
C) Për t'u mbrojtur, sajova një strehë në rrëzë të shkëmbit.
D) Dola të kërkoja të gjitha ato gjëra.

24. Ndërmjet dy fakteve të mëposhtme ka lidhje shkaku dhe pasoje/rrjedhimi. Ndërtoni një fjali të përbërë me nënrenditje shkakore dhe një me rrjedhimore. **2 pikë**

Era frynte shumë fort duke përmbysur dunat. Rëra fluturonte gjithandej duke depërtuar kudo.

Fjalia shkakore: _____

Fjalia rrjedhimore: _____

SEKSIONI 2



@matura.Shteterore

Testimi dhe modele testesh në Matematikë

Një nga komponentët më të rëndësishëm të zbatimit të kurrikulës me kompetenca në lëndën e matematikës është vlerësimi i nxënësit dhe veçanërisht vlerësimi nëpërmjet testeve të standardizuara. Testet përmbajnë pyetje të cilat zhvillojnë aftësitë kryesore dhe kompetencat matematikore, situata praktike nga jeta reale etj. “Modelet e testeve” bazohen në programet orientuese të lëndës së matematikës për AMU.

Kërkesat e testit janë të formatit me zgjedhje, me përgjigje të shkurtër dhe analizë.

I gjithë testi është vlerësuar me 50 pikë në total.



@matura.shteterore

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

Tabela e specifikimit (blueprint) të testit:

Nr	Tematikat	Përqindja	Pikë			
			Gjithsej	Niveli 1 40%	Niveli 2 40%	Niveli 3 20%
1	Numri <ul style="list-style-type: none"> • Numri, vendvlera, radha dhe rrumbullakimi • Bashkësia • Fuqitë dhe rrënjët • Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjestimi • Veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit 	37%	19 Pikë	6	7	6
2	Matja <ul style="list-style-type: none"> • Gjatësia dhe masa • Koha dhe njësitë e kohës • Perimetri, syprina dhe vëllimi 	14%	7 Pikë	4	3	
3	Gjeometria <ul style="list-style-type: none"> • Gjeometria në plan • Gjeometria në hapësirë • Shndërrime gjeometrike dhe sistemi koordinativ 	16%	8 Pikë	3	3	2
4	Algjebra dhe Funkzioni <ul style="list-style-type: none"> • Shprehjet shkronjore, ekuacionet dhe formulat • Vargu, funksioni dhe grafiku 	20%	10 Pikë	4	4	2
5	Statistikë, probabilitet <ul style="list-style-type: none"> • Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave • Probabiliteti 	13%	6 Pikë	3	3	
	Shuma	100%	50	20	20	10

Rezultatet e të nxënit në testin e Matematikës

Nxënësi:

- përdor radhën e veprimeve duke përfshirë kllapat dhe fuqitë;
- kryen veprime me fuqitë duke zbatuar vetitë;
- përdor në zbatime prerjen dhe bashkimin e dy bashkësive;
- shkruan një thyesë në formën më të thjeshtë duke thjeshtuar faktorët e përbashkët;
- gjen pjesën e një sasive të dhënë;
- zgjidh situata problemore duke përdorur përqindjen, në kontekste nga jeta familjare, veprime financiare etj;
- zgjidh situata problemore duke përfshirë përpjesëtimin;
- mbledh, zbret, shumëzon dhe pjesëton numrat e plotë, dhjetorë dhe thyesorë;
- njehson perimetrin dhe syprinën e katrorit, drejtkëndëshit, trekëndëshit, paralelogramit, trapezit;
- njehson gjatësinë e harkut dhe syprinën e sektorit qarkor;
- zgjidh situata problemore me perimetrin dhe syprinën e rrethit;
- zgjidh situata problemore që lidhen me vetitë e trekëndëshave, shumëkëndëshave dhe rrethit;
- njehson këndin qendror dhe këndin rrethor;
- identifikon trekëndëshat kongruentë bazuar në rastet e kongruencës;
- njeh dhe përdor teoremën e Pitagorës për të zgjidhur situata problemore në trekëndëshat kënddrejtë.
- përdor konceptin e eksponentit për fuqitë e numrave të plotë pozitivë;
- formon shprehje shkronjore;
- redukton dhe shndërron shprehjet shkronjore me koeficientë numra të plotë;
- kryen veprime me kufiza të ngjashme;
- shumëzon një kufizë me një shprehje brenda kllapës;
- gjeneron kufiza në një varg me një rregull të caktuar duke lidhur pozicionin e kufizës me kufizën ose kufizat me njëra -tjetrën;
- njeh kuptimin e koeficientit a dhe gjen koeficientin këndor të grafikut të funksionit linear $y = ax + b$;
- llogarit mesoren, modën dhe mesataren aritmetike për të dhënat diskrete dhe të vazhdueshme;
- njehson probabilitetin teorik dhe eksperimental dhe krahason rezultatet.

Testi përmban ushtrime në përputhje me programet orientuese në tri nivelet e të nxënësve. Ai mbështetet në të mësuarin me kompetenca, me problema edhe situata nga jeta reale.

Nëpërmjet testit të lëndës së matematikës në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë, nxënësi do të vlerësohet për realizimin e kompetencave matematikore nëpërmjet 5 tematikave kryesore:

- numri;
- matja;
- gjeometria;
- algjebra dhe funksioni;
- statistika dhe probabiliteti.

Qëllimi i testit është realizuar sipas kompetencave të shprehura më poshtë.

- Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik;
- Zgjidhja e situatave problemore;
- Arsyetimi dhe vërtetimi matematik;
- Modelimi matematik.



Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik

Nxënësi për këtë kompetencë duhet:

- të përdorë përkufizime matematikore,
- të interpretojë koncepte apo simbole matematikore.

Shembull:

1. Këndi i një trekëndëshi kënddrejtë është 55° . Masa e këndit tjetër është:

- A) 45°
- B) 40°
- C) 35°
- D) 30°

2. Vlerë e palejueshme e x në shprehjen $\sqrt{2x-4}$ është:

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

Rezultatet e të nxënit:

- vërteton dhe përdor formulën për shumën e këndeve të brendshëm të një trekëndëshi;

Zgjidhja e situatave problemore

Nxënësi për këtë kompetencë duhet:

- të kuptojë situatën e dhënë në një problemë matematikore;
- të interpretojë hapat e ndjekura për zgjidhjen e situatave problemore;
- të nxitë zhvillimin intelektual dhe intuitën krijuese.

Shembull:

Dy aeroplanë nisen njëkohësisht nga Parisi për në Tiranë. Njëri fluturon me shpejtësi 350 km/orë dhe tjetri me shpejtësi 280 km/orë.

Pas dy orësh aeroplani i parë e zvogëlon shpejtësinë me 230 km/orë. Në çfarë distance nga Parisi aeroplani i dytë arrin aeroplanin e parë?

Rezultatet e të nxënit:

- zgjidh situata problemore nga jeta reale;
- përdor njësitë e përbëra për të krahasuar konteskte të ndryshme të jetës reale.



@matfura.shteterore

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik

Nxënësi për këtë kompetencë duhet:

- të përzgjedhë informacionin e duhur nga një situatë e dhënë dhe ta interpretojë në një situatë praktike matematikore.

Shembull:

1. Perimetri i një drejtkëndëshi është 250 m. Gjatësia e tij është 5 m më e madhe se 3-fishi i gjerësisë. Gjeni syprinën e drejtkëndëshit;
2. Dy klasat e teta të një shkolle kanë 70 nxënës. Nota mesatare e të dy klasave është 7,2. Nota mesatare e djemve është 7,4, kurse nota mesatare e vajzave është 7. Gjeni sa vajza kanë të dy klasat e teta.

Rezultatet e të nxënit:

- njehson perimetrin e syprinëve katrorit, drejtkëndëshit, trekëndëshit, paralelogramit, trapezit.
- formon dhe zgjidh ekuacione të fuqisë së parë me një ndryshore, me koeficientë numra të plotë, me ose pa kllapa,
- zgjidh situata problemore duke përdorur ekuacione të fuqisë së parë;



@matura.shitetore

Modelimi matematik

Nxënësi për këtë kompetencë duhet:

- të përdorë teknikat përkatëse për të gjetur zgjidhjen e përshtatshme matematikore;
- të paraqesë zgjidhjen matematikore në zgjidhjen e situatës nga jeta reale.

Shembull:

Për të blerë një fustan Amela pagoi 2800 lekë. Kjo pagesë u krye pasi çmimi i fustanit pësoi një ulje prej 30%. Sa ishte çmimi fillestar i fustanit?

Rezultatet e të nxënit:

- zgjidh situata problemore duke përdorur përgjindjen, në kontekste nga jeta familjare, veprime financiare (psh. interesi i thjeshtë, uljet e çmimeve, fitimi, humbja, taksat).



@matura.kombetare

MODELI I



@matura.shqitereore

Për pyetjet 1-13 rrethoni vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Numri i elementeve të bashkësisë $A = \{x \in \mathbb{Z} / -4 \leq x < 1\}$ është: **1 pikë**

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

2. Hipotenuza dhe një katet i trekëndëshit janë 10 cm dhe 8cm. Syprina e tij në (cm²) është: **1 pikë**

- A) 40
- B) 24
- C) 30
- D) 48

3. Zgjidhja e ekuacionit $\frac{x}{3} - 2 = x$ është: **1 pikë**

- A) 3
- B) 2
- C) -3
- D) -6

4. Rrethi me perimetër 6π cm e ka syprinën në (cm²): **1 pikë**

- A) 3π
- B) 6π
- C) 9π
- D) 12π

5. 10 fletore dhe 5 lapsa kushtojnë 125 lekë. Çmimi i një lapsi është 5 lekë.
Sa është çmimi i një fletoreje? **1 pikë**

- A) 2 lekë
- B) 5 lekë
- C) 8 lekë
- D) 10 lekë

6. Shprehja $\frac{x^2 - 9}{x + 3}$ është e njëvlefshme me: **1 pikë**

- A) $x - 3$
- B) $x + 3$
- C) -3
- D) $x - 9$

7. Vlera e palejueshme me shprehjen $\frac{3x}{2-x}$ është: **1 pikë**

- A) 0
- B) 1
- C) 2
- D) 3

8. 30% e 150 është: **1 pikë**

- A) 45
- B) 50
- C) 75
- D) 100

9. Vlera e shprehjes $\sqrt{12} + \sqrt{3} - 2\sqrt{3}$ është: **1 pikë**

- A) $-\sqrt{3}$
- B) $\sqrt{3}$
- C) $-2\sqrt{3}$
- D) $2\sqrt{3}$

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

10. Në qoftë se një numër e shumëzojmë me 7 dhe i shtojmë 8, përfundimi është 50. Cili është ai numër? **1 pikë**

- A) 8
- B) 6
- C) 7
- D) 5

11. Një kënd rrethor pret harkun sa $\frac{1}{4}$ e rrethit. Masa e tij në gradë është:

1 pikë

- A) 90°
- B) 45°
- C) 60°
- D) 30°

12. 20 % e një numri a është 8. Vlera e a-së është:

1 pikë

- A) 40
- B) 30
- C) 20
- D) 8

13. Vlera e thyesës $\frac{8a^2b^3}{4a^{-1}b^2}$ është:

1 pikë

- A) $2ab$
- B) $2a^3b$
- C) $2ab^3$
- D) $2a^2b$

Pyetjet 14-25 janë me zhvillim dhe me arsyetim.

14. Në një trapez lartësia është 12 cm, kurse diagonalet 13 cm dhe 15 cm. Gjeni syprinën e trapezit. **4 pikë**

15. Perimetri i një drejtkëndëshi është 250 m. Gjatësia e tij është 5 m më e madhe se 3-fishi i gjerësisë.
Gjeni syprinën e drejtkëndëshit. **3 pikë**

16. Të zgjidhet sistemi: $\begin{cases} 2x - 3y = 5 \\ 3x + 2y = 14 \end{cases}$. **3 pikë**

17. Shuma e katër numrave të njëpasnjëshëm është 38.

a) Gjeni mesataren e tyre. **1 pikë**

b) Gjeni numrat. **2 pikë**

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

18. Gjeni vlerën e thyesës $\frac{8^{m+1}}{4^{m-1}}$ në varësi të a -së, nëse $2^m = a$. **4 pikë**

19. Shkruani ekuacionin e drejtëzës e cila është paralele me drejtëzën: $2x-y=1$ dhe kalon nga pika $A(1;3)$. **3 pikë**

20. 2250 vezë të një magazine përbëjnë 8% të të gjitha vezëve. Sa vezë ka gjithsej magazina? **2 pikë**



@matūra.shteterore

21. Herësi i dy numrave është 8 dhe mbetja 6 kurse shuma e tyre është 114. Gjeni dy numrat. **3 pikë**

22.

a) Të zgjidhet inekuacioni: $\frac{2x-3}{3} > \frac{3}{2}$. **2 pikë**

b) Paraqitni zgjidhjen në boshtin numerik. **1 pikë**

23. Sa do të jetë ndryshesa $x-y$, nëse $x^2 + y^2 = 2$ dhe $xy=1$. **3 pikë**

24. Një kordë e ndan rrethin në dy pjesë që rrinë si 3:12. Gjeni masën e këndeve qendrore që mbështeten në këto harqe. **3 pikë**

25. Hidhen dy zara të rregullt. Njëri i bardhë e tjetri i kuq. Gjeni probabilitetin që shuma e pikëve të rëna të jetë më e madhe se 9 kur dihet se zari i bardhë ka rënë numër çift. **3 pikë**

MODELI II



@matura.shteterore

Për pyetjet 1-13 rrethoni vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Perimetri i rrethit me rreze 3 cm është: **1 pikë**

- A) 6π
- B) 8π
- C) 10π
- D) 12π

2. Numri i elementëve të bashkësisë $A = \{x \in \mathbb{Z} / -4 < x < 1\}$ është: **1 pikë**

- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 5

3. Perimetri i trekëndëshit kënddrejtë me katete 6cm dhe 8cm është: **1 pikë**

- A) 16
- B) 20
- C) 22
- D) 24

4. Vlera e shprehjes $(0,22 + 0,78) \times (-0,3 - 0,7)$ është: **1 pikë**

- A) -2
- B) -1
- C) 1
- D) 2

5. Beni dhe Mira kishin 1000 lekë. Mira mori $\frac{2}{5}$ e lekëve. Sa lekë mori Beni?

1 pikë

- A) 200
- B) 400
- C) 500
- D) 600

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

6. Vlera e 20% të 150 është: **1 pikë**

- A) 30
- B) 40
- C) 50
- D) 60

7. Zgjidhje e ekuacionit $\frac{2x}{3} - 1 = \frac{x}{6}$ është numri: **1 pikë**

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

8. Inekuacioni $\frac{3x-3}{4} > 3$ ka si zgjidhje numrin: **1 pikë**

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

9. Këndi i një trekëndëshi kënddrejtë është 55° . Masa e këndit tjetër është: **1 pikë**

- A) 45°
- B) 40°
- C) 35°
- D) 30°

10. Nëse trefshit të një numri x i shtojmë 6, atëhere marrim 12. Vlera e x- është: **1 pikë**

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

11. Vlerë e palejueshme e x në shprehjen $\sqrt{2x-4}$ është: **1 pikë**

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

12. Nëse grafiku i funksionit $y = 2x + 4$ kalon nga pika $A(x;2)$, vlera e x është: **1 pikë**

- A) -1
- B) 1
- C) 3
- D) 4

13. Mesatarja e dy numrave të njëpasnjëshëm është 7,5. Numri më i vogël është: **1 pikë**

- A) 6
- B) 7
- C) 8
- D) 9



@matura.shtetore

Pyetjet 14-25 janë me zhvillim dhe me arsytim.

14. Të zgjidhet sistemi i ekuacioneve: $\begin{cases} x - 2y = 2 \\ 2x - 3y = 5 \end{cases}$ **3 pikë**

15. Dy klasat e teta të një shkolle kanë 70 nxënës. Nota mesatare e të dy klasave është 7,2. Nota mesatare e djemve është 7,4, kurse nota mesatare e vajzave është 7. Gjeni sa vajza kanë të dy klasat e teta. **4 pikë**

16. Jepet barazimi: $\frac{9^{2m-1}}{27^{m-1}} = 3^{2m}$. Gjeni vlerën e m duke kryer veprimet. **3 pikë**

17. Të zgjidhet inekuacioni: $\frac{x}{3} \geq \frac{x-1}{4}$ dhe paraqitni zgjidhjen në boshtin numerik.

3 pikë

18. Për të blerë një fustan Amela pagoi 2800 lekë. Kjo pagesë u bë pasi çmimi i fustanit pësoi një ulje prej 30%.

Sa ishte çmimi fillestar i fustanit?

3 pikë

19. Gjeni ekuacionin e drejtëzës që kalon nga pika A(2;1) dhe origjina e koordinatave.

3 pikë



@matura.shteterore

20. Perimetri i rrethit dhe sipërfaqja e qarkut përkatës janë numerikisht të barabartë. Gjeni sa njësi është rrezja e rrethit.

3 pikë

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

21. Të zgjidhet ekuacioni: $x(x - 2) = (2 + x)(x - 3)$. **3 pikë**

22. Numri x është sa trefishi i y . Gjeni raportin $\frac{x + 5y}{x - y}$. **3 pikë**

23. Në një klasë, 18 nxënës i bien pianos, 21 nxënës i bien violinës, kurse 8 nxënës i bien të dy veglave muzikore.

a) Sa nxënës ka klasa, nëse çdo nxënës i bie të paktën një vegle? **2 pikë**




@matura.shkolterore

b) Zgjidhet rastësisht një nxënës. Sa është probabiliteti që nxënësi i zgjedhur t'i bjerë violinës? **1 pikë**

24. Në trekëndëshin ABC jepen: $BA=AD=BC$ dhe $\widehat{CBD} = 60^\circ$.

a) Krahaso këndin A me këndin C.

1 pikë



b) Gjej vlerën e këndit x.

2 pikë



25. Dy aeroplanë nisen njëkohësisht nga Parisi për në Tiranë. Njëri fluturon me shpejtësi 350 km/orë dhe tjetri me shpejtësi 280 km/orë. Pas dy orësh aeroplani i parë e zvogëlon shpejtësinë me 230 km/orë. Në çfarë distance nga Parisi aeroplani i dytë arrin aeroplanin e parë?

3 pikë

MODELI III



@matura.Shteterore

Për pyetjet 1-13 rrethoni vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Hipotenuza dhe një katet i trekëndëshit kënddrejtë janë 10cm dhe 8 cm. Syprina e tij (në cm²) është: **1 pikë**

- A) 24
- B) 30
- C) 40
- D) 48

2. Inekuacioni $\frac{x}{2} > 3$ është i njëvlershëm me: **1 pikë**

- A) $x > 6$
- B) $x > -6$
- C) $x < -6$
- D) $x < 6$

3. Këndet e një trekëndëshi rrinë si 2:4:6. Këndi më i vogël i tij është: **1 pikë**

- A) 120°
- B) 100°
- C) 80°
- D) 30°

4. Perimetri i një rrethi është 8π cm. Syprina e tij (në cm²) është: **1 pikë**

- A) 10π
- B) 12π
- C) 14π
- D) 16π

5. Vlera e shprehjes $\frac{0,7}{70} + \frac{0,3}{30} + \frac{0,2}{20} + \frac{0,4}{40}$ është: **1 pikë**

- A) 0,01
- B) 0,02
- C) 0,03
- D) 0,04

6. Bashkimi i bashkësive $B =]-1; 5]$ dhe $C = [1; 2]$ është: **1 pikë**

- A) $] -1; 5[$
- B) $] -1; 5]$
- C) $] -1; 2]$
- D) $] 2; 5]$

7. Ekuacioni $ax - 4 = 0$ ka si rrënjë numrin 4. Vlera e a është: **1 pikë**

- A) 0
- B) 1
- C) 2
- D) 4

8. Vlera e $(2^{-2})^{-1}$ është e barabartë me: **1 pikë**

- A) -2
- B) -1
- C) 2
- D) 4

9. Vlera e shprehjes $\sqrt{12} + \sqrt{3}$ është: **1 pikë**

- A) $5\sqrt{3}$
- B) $4\sqrt{3}$
- C) $3\sqrt{3}$
- D) $2\sqrt{3}$

10. Vlera e shprehjes $\frac{2^{-2}}{2^{-4}}$ është:

1 pikë

- A) 1
- B) 2
- C) 4
- D) 8

11. Diagonalet e një rombi janë 12 dhe 16. Perimetri i tij (në cm) është: 1 pikë

- A) 20
- B) 30
- C) 40
- D) 60

12. Vlera e shprehjes $2a^2 - b$ për $a=3$ dhe $b= -2$ është:

1 pikë


- A) 20
- B) 16
- C) 14
- D) 8

13. 20 % e një numri k është 4. Vlera e k-së është:

1 pikë

- A) 40
- B) 30
- C) 20
- D) 8

@matura.shteterore



Pyetjet 14-25 janë me zhvillim dhe me arsytim.

14. Për ç'vlera të $x \in R$ vlera e shprehjes $\frac{x}{2}$ është më e vogël ose baraz se

vlera e shprehjes $\frac{2x+1}{3}$

2 pikë

15. Perimetri i një paralelogrami është 40cm. Njëra brinjë është sa $\frac{2}{3}$ e tjetrës.

Gjeni brinjët e paralelogramit.

3 pikë

16. Çmimi i një bluze fillimisht ishte 5000 lekë. Ai u rrit me 20% dhe pas një muaji u ul po me 20%.

Sa është çmimi i ri i bluzës pas një muaji?

2 pikë

17. Të zgjidhet sistemi:
$$\begin{cases} 2x + y = 5 \\ x - y = 1 \end{cases}$$

2 pikë

18. Një kordë e ndan rrethin në dy pjesë që rrinë si 4:14. Gjeni masën e këndeve qëndrorë që mbështeten në këto harqe. **3 pikë**

19. Nga porti i Vlorës nisen dy anije në të njëjtin drejtim njëkohësisht me shpejtësi 10km/orë dhe 15 km/orë. Sa do të jetë largesa midis tyre pas 2 orë? **3 pikë**

20. Të zgjidhet ekuacioni: $3(x + 2) + 4(x - 1) = 30$ **3 pikë**

21. Shkruani ekuacionin e drejtëzës që kalon nëpër pikat (0;4) dhe (6;-2). **3 pikë**

22.

a) Nëse $2^m = a$, gjeni vlerën e thyesës $\frac{8^{m+1}}{4^{m-1}}$ në varësi të a-së. **2 pikë**

b) Gjeni vlerën: $3x - 2y$ për $x = 21$ dhe $y = -2$. **2 pikë**

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

23. Kufiza e parë e vargut është 5. Rregulla kufizë pas kufize është “ shtoi 1 dhe shumëzoje me 2”.

Shkruani katër kufizat e para të këtij vargu.

3 pikë

24.

a) Më poshtë janë dhënë moshat e lojtarëve në vite të një skuadre futbollit:

18; 21; 22; 21; 35; 34; 21; 20; 23; 22; 24.

Gjeni modën, mesoren dhe mesataren aritmetike të moshave të lojtarëve.

2 pikë

b) Probabiliteti që Albana të shkojë me vonesë në shkollë, është 0,12. Në 200 ditë shkolle sa ditë parashikohet që Albana të shkojë më vonesë në shkollë?

2 pikë

25. Perimetri i një drejtëkëndëshi është 50m. Gjatësia e tij është 4m më e madhe se 2-fishi i gjerësisë.

Gjeni syprinën e drejtëkëndëshit.

3 pikë

SEKSIONI 3



@maturashitetere

**SKEMAT E VLERËSIMIT TË TESTEVE
GJUHË SHQIPE**



@matrapashitetere

MODELI I

PJESA I

Ja si u bëra tregimtar

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë



@matura.shteterore

Pyetja 5

4 pikë

Model përgjigjeje

Përgjigjja e dhënë duhet të përqendrohet në të paktën dy nga momentet e mëposhtme bashkë me ilustrimet përkatëse (më shumë se një):

- Familja e autorit e vlerësonte rrëfimin e historive.
- Në një familje të madhe, rrëfimi i historive ishte një mundësi për të tërhequr vëmendjen.
- Leximi respektohej shumë në shtëpinë e autorit.
- Familja e tij e vlerësonte shumë arsimin.

4 pikë

Përgjigjja jep një përshkrim **të plotë** për mënyrën se si fëmijëria e autorit ndikoi në vendimet e tij për t'u bërë shkrimtar. Ajo përmban detajet e duhura për ilustrim, të marra nga fragmenti.

3 pikë

Përgjigjja jep një përshkrim për mënyrën se si fëmijëria e autorit ndikoi në vendimet e tij për t'u bërë shkrimtar. Ajo përmban një detaj për ilustrim, të marrë nga fragmenti.

2 pikë

Përgjigjja jep një përshkrim **të pjesshëm** për mënyrën se si fëmijëria e autorit ndikoi në vendimet e tij për t'u bërë shkrimtar. Përgjigjja përmban një detaj ose asnjë nga pjesa për ilustrim.

1 pikë

Përgjigjja është **minimale** ose **e pamjaftueshme**.

0 pikë

Përgjigjja është e plotësisht e pasaktë.



Pyetja 12 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

Djali është një natyrë shumë e ndjeshme, emocionale. Ai e përjeton shumë historinë që i rrëfen vajza.

Kjo duket:


- Kur ngashërehet,
- Kur preket, kur vihet në merak,
- Kur i dalin lot në fund të historisë.

1 pikë Nëse përcakton natyrën e djalit.

DHE

1 pikë Nëse tregon me fjalët e veta ose shembuj nga fragmenti se ku shfaqet kjo natyrë e tij.

0 pikë Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.



@matura_shteterore

Pyetja 12 (b) 2 pikë

Model përgjigjeje

Djali ka një imagjinatë të zhvilluar dhe kjo shfaqet në dy momente:


- Kur Izabela i duket si vajza e përrallës, krejt e bardhë, mes borës dhe ai hidhet t'i shkojë në ndihmë.
- Kur e shikon Izabelën të ngrihet lart në ajër, mbajtur përdore nga gjyshja e saj.

1 pikë Nëse identifikon momentin e parë kur imagjinata e djalit shfaqet shumë e dukshme.

DHE

1 pikë Nëse identifikon momentin e dytë kur imagjinata e djalit shfaqet shumë e dukshme.

0 pikë Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.



@matra.shteterore

Pyetja 12 (c) **1 pikë**

Model përgjigjeje

Izabela qesh,

OSE

E vë në lojë,

OSE

I thotë se është budalla.

1 pikë Nëse tregon si reagon Izabela.

0 pikë Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.



@matura.shteterore

Pyetja 13 (a) 3 pikë

Model përgjigjeje

- Izabela është një interpretuese shumë e mirë. Ajo ia përshtat gjestet dhe mimikën momentit të historisë që po tregon. Në momentin kur historia është e trishtuar, zëri i saj i krijon djalit të vogël pikërisht këtë përshtypje.
- Është pikërisht Izabela ajo që, me mënyrën e interpretimit, bën që djali të përfshihet emocionalisht në ngjarje. Prandaj ajo është një interpretuese shumë e mirë.

Psh:

- shpesh zëri i saj bëhet *therrës nga zemërimi ose shpreh gëzim,*
- u bënte një përshkrim të arrirë këtyre përfytyrimeve të mrekullueshme,
- u mëshoi me një ton të ngadaltë,
- mezi i doli zëri për të vijuar,
- e kishte marrë me mjaft seriozitet dhe lexonte me këmbëngulje,
- herë zë të ftohtë e monoton si bora që binte, herë zë lakmues e të ngrohtë,

OSE

- Izabela është një interpretuese e zonja, por edhe një vajzë e ndjeshme, pasi, sado të përpiqesh të interpretosh bukur, nuk mund t'ia arrish kësaj nëse nuk e ke kuptuar pjesën, nuk e ke ndjerë atë. Nuk ka mundësi që emocionet e saj, kur gëzohet apo hidhërohet, të jenë vetëm për shkak të interpretimit.

Ilustrim:

Izabela u mëshoi me një ton të ngadaltë, me një dhembshuri që ia dridhte, ia mbyste zërin dhe, kur ajo tha: “*vdekur, vdekur nga të ftohtët, natën e fundit të vitit*”, nuk kishte si të vijonte më tej dhe **lot të sumbullt** i rrodhën përgjatë faqeve të zbehta.

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

2 pikë Përgjigjja shpreh pozicionin e nxënësit nëse mendon se Izabela është një interpretuese apo vajzë e ndjeshme.

DHE

1 pikë Ilustrimi me detaje për të mbështetur pozicionin e marrë.

OSE

1 pikë Nëse nxënësi shpreh një pozicion të caktuar, por nuk e mbështet me detaje.

0 pikë Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.



@matura.shteterore

Pyetja 13 (b) 2 pikë

Model përgjigjeje

Mendimi i nxënësit është i pavarur.

➤ Vajza më duket paragjyquese.

Nuk jam dakord me fjalët që ajo thotë, pasi si djemtë edhe vajzat ndikohen nga historitë e trishtuara. Emocionet janë për të gjithë njerëzit dhe s'më duket e drejtë që një djalë të mbetet i pandjeshëm.

OSE

➤ Vajza më duket e nxituar në mendimin e saj.

Nuk ka pse mendon se lotët janë vetëm për vajzat, pasi nuk ka asgjë të keqe nëse djemtë preken. Histori të tilla nuk janë vetëm për vajza.

OSE

➤ Vajza nuk gjykon drejt.

Këto janë stereotipa që ndajnë në mënyrë të padrejtë djemtë dhe vajzat.

Nëse diçka është e bukur, e trishtuar, e dhimbshme apo tragjike, kjo mund të provohet në mënyrë personale nga kushdo, qoftë djalë apo vajzë.

OSE

➤ Vajza mendon gabim.

Emocionet janë një çështje personale. Varet nga tipi i njeriut dhe jo nga fakti se je djalë apo vajzë. Ka shumë vajza që nuk qajnë dhe kjo s'do të thotë asgjë, sikurse ka djem të ndjeshëm që emocionohen menjëherë.

S'kemi pse i paragjykojmë.

OSE

➤ Vajza mendon drejt.

Në fund të fundit, është një përrallë dhe s'ka arsye pse ta përjetojë aq shumë dhe ta marrë aq seriozisht. Dihet se përrallat nuk janë të vërteta.

OSE

- Vajza mendon drejt.

Djemtë janë natyra të forta dhe s'kanë pse qajnë.

1 pikë Nëse shkruan se çfarë mendon në lidhje me fjalët e vajzës.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon në është dakord ose jo me fjalët e saj.

0 pikë Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.



@matura@teterore

Pyetja 13 (c) 1 pikë

- Edhe pse është një përrallë, më erdhi keq për fatin e vajzës.
 - S'ka rëndësi nëse jam djalë apo jo. Edhe një djalë mund të preket nga histori të tilla.
 - S'është turp që një djalë të përlozet.
 - Historia ishte aq e bukur, sa për një çast e mendova si të vërtetë.
 - Ti e tregove kaq bukur, sa më bërë të prekem.
- Etj

1 pikë Nëse imagjimon se çfarë mund të ketë thënë djali për të mbrojtur veten e tij.

0 pikë Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

Pyetja 13 (d) 1 pikë

Model përgjigjeje

Fjalët ose fjalitë që janë me shkronja të pjerrëta dhe të vendosura mes thonjzash, janë të marra nga përralla. Ato janë të tilla për t'i dalluar nga pjesa tjetër e tregimit.

OSE

Këto janë fjalë ose fjali të shkëputura nga përralla.

1 pikë Nëse shpjegon pse këto fjalë ose fjali janë me shkronja të pjerrëta dhe të futura mes thonjzash.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.



@matura.shkollorore

PJESA III

Pyetja 14 **C** **1 pikë**

Pyetja 15 **A** **1 pikë**

Pyetja 16 **B** **1 pikë**

Pyetja 17 **2 pikë**

1 pikë **mbiemri:** krejt të bardhë

1 pikë **shkalla:** sipërore

Pyetja 18 **2 pikë**

1 pikë **fjala e përngjitur:** mirëpo

1 pikë **klasa:** lidhëz

Pyetja 19 **2 pikë**

1 pikë **atëherë:** ndajfolje (kohe)

1 pikë **atmosferike:** mbiemër

Pyetja 20 **1 pikë**

1 pikë **përemri:** i pacaktuar

Pyetja 21 **1 pikë**

1 pikë **Kryefjala** këto vezullime (gr- emëror)

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË

Pyetja 22 1 pikë

1 pikë kallëzuesi i përbërë: zuri të fliste

Pyetja 23 (a) 2 pikë

1 pikë rrethanorë:
midis borës Lloji: rr. Vendi 1 pikë

1 pikë lehtë Lloji: rr. mënyre 1 pikë

Nxënësi mjafton të gjejë një rrethanor dhe llojin e tij.

Ai do të marrë një pikë për rrethanorin e gjetur saktë dhe një pikë për përcaktimin e llojit të tij.

Pyetja 23 (b) 2 pikë

1 pikë mënyra: lidhore

1 pikë koha: e pakryer

Pyetja 24 (a) B 1 pikë

Pyetja 24 (b) 1 pikë

1 pikë Lloji: mënyrore

Pyetja 25 **6 pikë**

Në vlerësimin e rubrikës *të shkruajmë* duhet pasur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pyetjes, do të marrin pikët e plota për *shtjellimin e idesë*. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë pyetjes, do të marrin pikë për *stilin* dhe *saktësinë drejtshkrimore*, por nuk do të vlerësohen për *shtjellimin e idesë*.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që ju i gjykoni si të rënda.

Kriteret e vlerësimit

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shpjegon se si ndikojnë fjalët në jetën tonë;
- shprehet qartë, përmes detajeve dhe shprehjeve të përzgjedhura, për ndikimet që ka pasur;
- përdor ilustrime mbështetëse;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: STRUKTURA

1 pikë

- respekton elementet e një eseje:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr 1 pikë nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

1 pikë

- krijon, përmes gjuhës që përdor, një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta;
ka saktësi drejtshkri



@matura.shteterore

Pyetja 7

2 pikë

Model përgjigjeje

Përgjigje e plotë

- Një letër e shkruar kohë më parë na sjell shumë kujtime, na risjell pjesë të një historie ndoshta të harruar, na ngjall nostalgji për diçka që mund të mos kthehet më.

OSE

- Letrat na lidhin me persona që mund të mos jenë më, që kanë qenë ose janë pjesë e jetës sonë të shkruar dhe të tanishme. Aty rizbulojmë detaje dhe copëza jete të harruara. Mënyra si është shkruar, na bën të rijetojmë emocione dhe ndjenja të përjetuara kohë më parë dhe që janë ende brenda nesh.

Përgjigje e pjesshme

- Letrat na ngjallin kujtime.
- Një letër e shkruar me dorë na bën të jetojmë emocione të harruara.
- Një letër na kujton ngjarje të harruara.

2 pikë

Nëse zberthen në mënyrë të plotë nëntekstin e fjalisë së dhënë.

1 pikë

Nëse zberthen në mënyrë të pjesshme nëntekstin e fjalisë së dhënë.

0 pikë

Përgjigja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

PJESA II *Udhëtim në mbretërinë e pemëve*

Pyetja 8 **A** **1 pikë**

Pyetja 9 **B** **1 pikë**

Pyetja 10 **C** **1 pikë**

Pyetja 11 **A** **1 pikë**

Pyetja 12 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- Të jetë i shkuar nga mosha (i moçëm) dhe të dijë shumë gjëra (të ketë mësuar shumë gjëra).

2 pikë Nëse zbulon dy veçori që i duhen një lisi për t'u bërë mbret.

1 pikë Nëse zbulon një veçori që i duhet një lisi për t'u bërë bret.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 13 (a) 2 pikë

- **E veçanta:** janë prapashtesa ndjesore, zvogëluese.
- **Funksioni:** prapashtesat theksojnë faktin se gjithçka shikohet me sytë e një fëmije. Është vetë prirja e fëmijës për t'i zvogëluar ose zmadhuar gjërat, për të mos i parë me përmasat reale, por për t'i ekzagjeruar.

OSE

- Theksohet fantazia e vogëlushit, imagjinata e tij.

1 pikë Nëse tregon të veçantën e prapashtesave.

1 pikë Nëse tregon funksionin e tyre.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 13 (b) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Përforcon mohimin (përforcon kuptimin mohor).

OSE

- E nxjerr më shumë në pah, e thekson atë.

1 pikë Nëse tregon rolin e përsëritjes së lidhëzës *as*.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 14 (b) 2 pikë

Model përgjigjeje

Përgjigje e plotë

- JO. Djali nuk është thjesht një vizitor, pasi ne ndiejmë një lidhje të brendshme midis tij dhe pyllit. Mënyra se si ai komunikon me pemët, tregon më se miri këtë lidhje ndjesore mes tyre. Ai i vesh pyllit tipare njerëzore (*pemët kanë sy, flasin, lëvizin* etj), flet me të, e kupton, e ndien. Pra, në një farë mënyre, ai është bërë pjesë e pyllit.
- Një vizitor i thjeshtë nuk do të shikonte kaq shumë detaje dhe nuk do të krijonte përfytyrime të tilla.

Përgjigje e pjesshme

- Jo. Djali nuk është thjesht një vizitor, pasi duket që ai e njeh mirë pyllin.
- Atij i pëlqen pylli dhe ndihet mirë kur është mes pemëve.
- Ai flet me pemët dhe krijon përfytyrime të ndryshme në lidhje me to.

2 pikë

Nëse argumenton në mënyrë të plotë se pse djali nuk është një vizitor i thjeshtë në pyll dhe e mbështet argumentimin me detaje ose pjesë nga historia, të drejtpërdrejta ose të nënkuptuara.

1 pikë

Nëse argumenton në mënyrë të pjesshme se pse djali nuk është një vizitor i thjeshtë në pyll dhe përgjigjen nuk e mbështet me detaje ose pjesë nga historia.

0 pikë

Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

Pyetja 14 (b) 2 pikë

Momentet:

- Djali flet me pemët.
- Djali krijon përfytyrime sikur pemët lëvizin, kanë sy të të gjitha ngjyrave, sikur flenë, janë të egra, të ndrojtura etj;
- *Çdo sy vështron vogëlushin e ulur mes çeltnës me një ndjesi vërtetë të çuditshme, sepse vështrimet i kanë shumë të ëmbla.*
- *... kur shohin dikë që iu avitet, shtrëngojnë darën e rrënjëve të tyre dhe bëjnë sikur kanë fjetur.*

2 pikë Nëse identifikon dy momente në fragment, **të perifrazuara ose të cituara**, ku kjo imagjinatë shfaqet dukshëm.

1 pikë Nëse identifikon një moment në fragment.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.



@matura.shitetore

Pyetja 14 (c) 3 pikë

Përgjigje e plotë

- Jo, sepse këtu tregohet dhe theksohet më shumë ana jetësore e pemëve, si gjallesa të natyrës, e cila jepet me kuptimin e fjalës *mbretëri*. Gjithashtu thekson edhe prania e një bote sa reale aq edhe imagjinare, ku sundon e bukura, e magjishmja, fantastikja. Ndërsa kuptimi i fjalës *pyll* lidhet më shumë me sasinë e gjësë, që në rastin tonë janë drurët në një sipërfaqe toke.
- **Ilustrime:** *Pemët nuk janë të palëvizshme. Ato duket sikur flenë, sikur bien në gjumë të thellë që zgjat me shekuj. Po vetë vogëlushi e dinte farë mirë se pemët s'flenë. Vetëm se janë disi të egra e të ndrojtura, dhe kur shohin dikë që iu avitet, shtrëngojnë darën e rrënjëve të tyre dhe bëjnë sikur kanë fjetur*

Përgjigje e pjesshme

- Jo, sepse këtu tregohet dhe theksohet më shumë ana jetësore e pemëve si gjallesa të natyrës, e cila jepet me kuptimin e fjalës *mbretëri*, ndërsa kuptimi i fjalës *pyll* lidhet më shumë me numrin e madh të pemëve në një sipërfaqe toke.

2 pikë

Nëse shpjegon në mënyrë të plotë ndryshimin midis dy emërtimeve.

DHE

1 pikë

Nëse jep ilustrimin e duhur që lidhet natyrshëm me shpjegimin e dhënë.

OSE

1 pikë

Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme ndryshimin midis dy emërtimeve.

0 pikë

Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

PJESA III

Pyetja 15 **A** **1 pikë**

Pyetja 16 (a)

1 pikë *fsh* - prapashtesa trajtëformuese

1 pikë *a* - mbaresa

Nëse nxënësi nuk i emërton morfemat trajtëformuese, por vetëm i gjen, ai do të marrë 0 pikë.

Pyetja 16 (b)

1 pikë antonime: e butë – e egër; është një mashtrim - ishte e vërtetë, e egër- e ndrojtur, flenë-s' flenë, qëndrojnë në të njëjtin vend- nuk janë të palëvizshme.

Pyetja 16 (c)

1 pikë lidhëza

Pyetja 17 **C** **1 pikë**

Pyetja 18

1 pikë më të madhe- shkalla krahasore

Pyetja 19 (a)

1 pikë asaj gjëje

Pyetja 19 (b)

1 pikë mënyra: dëshirore koha: e tashme

Pyetja 20

1 pikë kryefjala: kurrkush

1 pikë shprehur me: përemër të pacaktuar

Pyetja 21 (a)

1 pikë Lloji: kallëzues emëror

1 pikë shprehur me: foljen këpujë *janë*+mbiemrin të *palëvizshme*

Pyetja 21 (b)

1 pikë lloji: rrethanor sasie

1 pikë shprehur me: emër me parafjalë

Pyetja 22

1 pikë *Të tërë në kuti shkrepësesh kanë për të përfunduar, kështu që kot mburren.*
(Pranohen të gjitha rastet kur formohet fjali me pjesë të nënrenditur rrjedhimore)

Pyetja 23 C **1 pikë**

Pyetja 24 D **1 pikë**

Pyetja 25 6 pikë

Për pjesën *të shkruajmë* do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- tregon se çfarë dëshiron të pikturojë;
- përshkruan qartë, përmes detajeve dhe shprehjeve të përzgjedhura veprën e tij, duke krijuar përfytyrime tek lexuesi;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: STRUKTURA

1 pikë

- respekton elementet e një eseje:
 - hyrjen;
 - zhvillimin;
 - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

1 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta;
- ka saktësi drejtshkrimore.



@matura.shteterore

MODELI III

PJESA I

Besimi

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë

Pyetja 7 (a) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Autori ndihet krenar në fund, pasi ka bërë një veprim pa e detyruar njeri ta bëjë. Ishte vullneti i tij për ta bërë dhe e bëri.

1 pikë Nëse gjen arsyen pse autori ndihet krenar në fund.

0 pikë Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 7 (b)

1 pikë

Model përgjigjeje

- Autori ka dëshiron që të tjerët ta dinë sa njeri i mirë është, pasi ka nevojë të konfirmohet.

OSE

- Atij s'i mjafton që e di vetë veprimin e mirë që ka bërë, por për të ka rëndësi që edhe të tjerët ta dinë këtë.

1 pikë

Nëse tregon se pse autori ka nevojë që të tjerët ta dinë sa njeri i mirë është.

0 pikë

Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.



PJESA II

Largimi

Pyetja 8 B 1 pikë

Pyetja 9 D 1 pikë

Pyetja 10 D 1 pikë

Pyetja 11 A 1 pikë

Pyetja 12 C 1 pikë

Pyetja 13 (a) 1 pikë

Model përgjigjeje

➤ **Arsyeja:**

- Dëshira për të qenë vetëm, në qetësi, pranë natyrës.
- Dëshira për të bërë diçka ndryshe.
- Djali e do lumin dhe varka, ku ai ndihet i sigurt, i krijon mundësinë që të jetë më pranë tij, ta ndiejë atë (lumin).

1 pikë Nëse gjen arsyen se pse djali hipi në varkë.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 (b) **2 pikë**

➤ **Rreziqet:**

- Mund ta marrë lumi me vete
- Rrjedha e rrëmbyeshme mund ta përplasë varkën me shkëmbin dhe aty mund të copëtohet.
- Varka është e vjetër dhe fut ujë, dhe kështu mund të fundoset.

2 pikë Nëse identifikon nga pjesa e dhënë dy rreziqe që i kanosen djalit.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një rrezik.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.



@matura.shqeterore

Pyetja 14 **2 pikë**

- **Momenti:** *Megjithëse zemra më rrihte fort nga një ndjenjë frike e pakuptueshme, ndihesha po prapë i lumtur.*

Përgjigjja e dhënë shpjegon qartë arsyen e këtij përjetimi kontradiktor duke theksuar nga një anë **frikën** dhe çfarë e shkakton atë dhe nga ana tjetër **lumturinë** dhe arsyen e kësaj ndjenje.

- Djali ndihej i frikësuar se ndodhej i vetëm në një mjedis të panjohur për të. Ai po bënte diçka që nuk e kish bërë më parë (u largua nga familja i vetëm) dhe po kalonte situata të vështira dhe të paprovuara, si: *po hipte në barkë i vetëm; animi i anijes; frika se mos binte në ujë nga çasti në çast*. Të gjitha këto krijojnë një gjendje frike dhe pasigurie tek djali.

Mirëpo, nga ana tjetër, vogëlushi ka një dëshirë të madhe të jetë i lirë, i pavarur dhe të provojë gjëra që nuk i ka bërë më parë. Është pikërisht, kjo e dyta që e bën djalin të ndihet i lumtur edhe në këto momente frike dhe ankthi.

Përgjigje e gabuar

Nëse shpjegon vetëm një nga ndjesitë ose nuk e jep të plotë arsyen e këtyre dy përjetimeve, nxënësi do të marrë **0 pikë**.

- Ka frikë se është vetëm.
- Është i lumtur se mund të provojë gjëra të ndryshme.

1 pikë Nëse identifikon në fragment momentin.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të plotë arsyen e këtij përjetimi.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk përafrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

Pyetja 15 (a) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Djali kupton se është në një gjendje të dëshpëruar, është vetëm dhe larg familjes, pa asnjë mundësi komunikimi.

1 pikë Nëse tregon se çfarë kupton djali në lidhje me gjendjen në të cilën ndodhet.

0 pikë Nëse përgjigja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.



@matura.shqiperore

Pyetja 15 (b) 2 pikë

Model përgjigjeje

➤ Çlirim që shpëtoi gjallë.

OSE

➤ Frikë, ankth nga situata pa shpresë ku ndodhet.

➤ **Arsyeja:**

- Djali realisht kaloi një situatë shumë të rrezikshme kur ishte në lum. Varka mund të përplasej me shkëmbin ose mund të mbytej pasi fuste ujë. Ndaj lotët në sytë e tij janë çlirim që shpëtoi gjallë, një marrje fryme lirisht.

OSE

- Djali, edhe pse shpëtoi, është në një gjendje të pashpresë: i vetëm, larg familjes, pa mundësi që t'u thotë njerëzve të tij se ku ndodhet. Ndaj lotët në sytë e djalit, janë frikë nga situata në të cilën ndodhet.

1 pikë Nëse gjen se pse qan djali në fund.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen se pse ai qan.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

Pyetja 15 (c) 2 pikë

Model përgjigjeje

- Djali, i ndodhur larg shtëpisë dhe në situatë të vështirë, ndien mall për gjithçka që lidhet me vatrën familjare. Është e qartë që njeriu në situata të vështira kërkon mbështetje dhe gjen siguri tek njerëzit e afërt, ndaj djali kujton çaste që e lidhin me ta.

OSE

- Vogëlushi përjeton njëkohësisht dy ndjenja: frikë dhe përmallim, prandaj ai përfytyron kur *tymosnin vatrën e ngrohta familjare; shtëpia ime, në atë kaltërsi agullore, duhej të kishte nisur përpjetë fjollën e vet të tymit; hallë Martina duhej të kishte ndezur zjarrin bubulak me shkarpa...*

Krahas të tjerave, përdorimi i foljes gjysmëndihmëse *duhej* na tregon se vogëlushi kujton dhe hamendëson për ato që mund të kishin ndodhur në familjen e tij, duke na vërtetuar kështu përmallimin dhe lidhjen e fortë të tij me familjen.

1 pikë Nëse zbërthen domethënien e pjesës.

DHE

